

**jetojmë më mirë  
së bashku**



#### Volumi i primeve (Euro)

Group	<b>84,446,000</b>
AL	<b>48,276,000</b>
KS	<b>15,505,000</b>
MK	<b>20,665,000</b>

#### Nr. i zyrave

Group	<b>1142</b>
AL	<b>684</b>
KS	<b>80</b>
MKV	<b>378</b>

#### Nr. i kontratave

Group	<b>1,111,225</b>
AL	<b>402,619</b>
KS	<b>118,438</b>
MK	<b>590,168</b>

#### Agjentë dhe punonjës

Group	<b>1973</b>
AL	<b>1300</b>
KS	<b>218</b>
MKV	<b>455</b>

#### FJALA PËRSHËNDETËSE

Z. Andreas BRANDSTETTER  
CEO i UNIQA Insurance Group  
Z. Avni PONARI,  
CEO i SIGAL UNIQA Group AUSTRIA  
DY FJALË PËR UKRAINËN SI PJESË E  
UNIQA INSURANCE GROUP

#### KUSH JEMI NE?

Misioni  
Parimet dhe vlerat tona  
Çfarë kërkojmë të jemi  
Çfarë është e rëndësishme për ne  
Kush jemi "SIGAL"  
Kush është "UNIQA"

#### PERFORMANCA NË 2021

Ngjarjet kryesore 2021  
Ngjarjet kryesore nga UNIQA  
Insurance Group  
Marketingu  
Media  
Përgjegjësia sociale në sport, art,  
kulturë, edukim dhe punësim  
Produktet, shërbimet dhe inovacionet  
e reja dixhitale

#### TREGU RAJONAL I SIGURIMEVE

#### RAPORTI I AUDITUESIT TË

#### PAVARUR

#### RAPORTI I AUDITUESIT TË BRENDSHËM

#### PARIMET E MENAXHIMIT TË RISKUT

#### OBJEKTIVAT

#### KONTAKTE

# jetojmë më mirë së bashku

Gjatë vitit 2021, SIGAL UNIQA Group AUSTRIA ka arritur më shumë rritje dhe inovacion, ka bërë më shumë investime dhe ky ishte viti i parë i zbatimit të programit të ri strategjik **"UNIQA 3.0 – Formësojmë të Ardhmen"** e UNIQA Insurance Group, ku bën pjesë SIGAL UNIQA. Kjo tregon se Grupi SIGAL UNIQA është një partner i besueshëm për të gjithë përfituesit e saj: klientët, partnerët, investitorët dhe punonjësit, madje edhe në kohë të trazuara – duke përfshirë pandeminë COVID-19 dhe tani konfliktin Rusi-Ukrainë. **Një vit financiar i shkëlqyer 2021**, na lejon ta shohim të ardhmen me shpresë dhe optimizëm. Përvoja jonë e gjatë dhe e konsoliduar na jep forcat për të përballuar sfidat aktuale së bashku, me besim dhe vendosmëri.

Ne dëshirojmë të jemi zgjedhja e parë për klientët tanë. Klientët dhe partnerët tanë na shohin si një partner të qëndrueshëm dhe të besueshëm. Diçka e tillë na mundëson konsolidimin e pozicionit tonë si grupi lider i sigurimeve në Shqipëri dhe më gjerë në rajon, në Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut. Ne jemi për stabilitetin dhe kompetencat në fushën e mbrojtjes së riskut. Ne e përdorim përvojën, dijet dhe diversitetin tonë për të qenë më afër klientëve tanë. Ne e shohim si përgjegjësinë tonë mbrojtjen e vlerave që kanë më shumë rëndësi për klientët tanë. Ne i mundësojmë klientëve tanë të jetojnë një jetë më të sigurt dhe më të mirë, duke mbrojtur gjithçka është më e rëndësishme për ta.

**SIGAL UNIQA – jetojmë më mirë së bashku**

*Të dashur zonja dhe zotërinj,  
Të dashur aksionerë*

Një artikulum i qartë ofron drejtimin për të cilin kemi nevojë në kohë të pasigurta. Domosdoshmërisht jo siguri, por të paktën drejtim. Rrjedhimisht, kjo letër e shkurtër përmban dy mesazhe të thjeshta.

• Gjithçka që është në vetë duart e UNIQA po shkon aktualisht sipas planit. Viti financiar i shkëlqyer 2021, i pari i programit tonë strategjik "UNIQA 3.0 – Formësojmë të Ardhmen", është prova për këtë. Biznesi ynë kyç gjithashtu ka performuar shkëlqyeshëm në javët e para të vitit 2022.

• Gjithçka që është jashë duarve tona si pasojat afatgjata të luftës shkatërruese të Federatës Ruse në agresionin kundër Ukrainës, ne po përpiqemi t'ia dalim sa më mirë të mundemi. Rrjedha e vitit financiar 2022, të cilin mezi po e prisim me gëzim dhe besim vetëm pak muaj më parë, është tani i lidhur natyrisht me pasiguri të konsiderueshme. Për ne, kjo deklaratë është e dhimbshme në përgjegjësinë tonë kundrejt jush, por ajo reflekton sinqeritetin e kërkuar.

#### **Përmirësime të konsiderueshme të biznesit kyç në vitin 2021**

Ne u rritëm 14.2 për qind sipër pritshmërive tona, e mbështetur nga integrimi i plotë fillestar i ish-kompanive të AXA në Poloni, Republikën Çeke dhe Sllovaki. Me një volum primesh prej 6,358 milionë euro, ne regjistruam një raport kostosh prej 27.4 për qind, e cila përbën një përmirësim me dy për qind, dhe një raport të kombinuar të reduktuar konsiderueshëm prej 93.7 për qind. Kjo pavarësisht faktit se, pagesat tona ndaj klientëve për humbjet e ndodhura lidhur me stuhitë arritën në një shumë totale bruto prej 267 milionë euro dhe se pesha nga humbjet kryesore ka qenë gjithashtu në mënyrë të konsiderueshme sipër mesatares afatgjatë. Në anën tjetër, ndihma erdhi nga e ashtuquajtura "humbjet bazë", e cila reflekton fitime të shkëlqyera teknike të klientit tonë privat të biznesit dhe nga kontributet e partnerëve tanë ndërkombëtar të risigurimeve.



#### **Fitime inkurajuese të kapitalit dhe aftësisë paguese**

Të ardhurat neto nga investimet prej 648 milionë euro janë 143 milionë euro apo 28 për qind sipër nivelit të një viti më parë. Tre arsytet më të rëndësishme për këtë janë fitimet nga fondet e kapitalit dhe obligacionet me interesa fikse prej nën 90 milionë euro, fitimet e përcaktuara prej 27 milioë euro në 'UNIQA Ventures' dhe të ardhurat më të larta nga pjesëmarrja jonë në grupin e ndërtimit 'STRABAG SE' prej 12 milionë euro. Fitimi mesatar mbi investimet tona të reja (duke arritur në total rreth 1.8 milionë euro) u rrit nga 2.07 për qind në 2.3 për qind. Kërkesat tona të raportit të kapitalit të aftësisë paguese sipas Aftësisë Paguese II, u rritën dukshëm nga 170 për qind në 196 për qind.

Ne po punojmë aktivisht dhe të angazhuar me Marrëveshjen e Gjellbër të Bashkimit Evropian. Pas bashkimit me Alenacën Globale të Pronarëve të Net-Zero, ne aplikuar gjithashtu për zbatimin e Aleancës së Financave të Gjellbra në Austri me nismën e Ministrisë Federale për Ndryshimet Klimatike, Mjedisin, Energjinë, Lëvizshmërinë, Inovacionin dhe Teknologjinë. Rritja e shpejtë e interesit personal të kaq shumë kolegëve tanë në këtë tematikë mund të shihet brenda kompanisë sonë, megjithëse ne nuk mund të vlerësojmë ende burimet totale të kërkuara për zbatimin e të gjithë objektivave në detaje të mjaftueshme.

**“Lufta ruse e agresionit në Ukrainë është absolutisht e kundërta e asaj për të cilën ne jemi: jetojmë më mirë së bashku.”**

**“Pas një viti 2021 jashtëzakonisht të suksesshëm me një performancë të fortë në biznesin kyç, ne shohim rezultate të mira në investime dhe një zhvillim shumë të kënaqshëm të fitimeve tona.”**

**Rezultatet vjetore 2021 sipër parashikimit të fitimeve, dividendi në nivelet e para pandemisë**

Fitimet përpara tatimeve arritën në total 382 milionë euro dhe janë rrjedhimisht edhe një herë sipër parashikimeve të fitimeve prej 330-350 milionë euro, e cila ishte rritur tashmë në verë. Me një nivel taksash prej 17 për qind, fitimet neto për vitin prej 315 milionë euro, na lejuan të propozonim një dividend prej 0.55 euro për aksion në Takimin e Asamblesë së Përgjithshme në maj, në një linjë me nivelet e para pandemisë së vitit financiar 2018 (0.53 euro për aksion). Raporti pagues është 53.5 për qind, e cila është brenda gamës tonë strategjike prej 50-60 për qind.

Viti financiar 2021, ka qenë një nga vitet më të mira në historinë e kompanisë sonë, ndoshta viti ynë më i mirë. Ai ishte gjithashtu një burim lumturie dhe krenarie për ne.

#### **Lufta në lindje**

Shtatë javë më vonë, gjithçka ishte ndryshe. Sulmi i Federatës Ruse mbi vendin tonë fqinjë Ukrainën, më 24 shkurt 2022 ka shkaktuar një katastrofë humanitare, e cila na ka shtangur të gjithëve, duke na lënë të zbehur përballë pasojave ekonomike – edhe nëse këto të fundit do të vazhdojnë të lënë gjurmët e tyre globalisht në vitet e ardhshme.

UNIQA në Ukrainë është kompania e dytë më e madhe e sigurimeve në vendin e ri. 850 kolegët tanë i shërbejnë me entuziazëm, krenari dhe disiplinë rreth 1.2 milionë klientëve ndërmjet Lviv-it në perëndim dhe Kharkiv-it në lindje, dhe gjenerojnë rreth 100 milionë euro në prime. Ne ende kemi vazhduar të punojmë për klientët për që kohë sa diçka e tillë është e mundur nga pikëpamja teknike javë pas fillimit të luftës, duke regjistruar dëme, paguar përfitime dhe ofruar asistencë 24/7 nëpërmjet Qendrës sonë të Telefonatave Mjekësore.

Vjenë, prill 2022

Urimet më të mira,

**Andreas Brandstetter**

CEO, Uniqa Insurance Group

Kryetar i Bordit Mbikëqyrës të SIGAL UNIQA



*Të dashur partnerë  
dhe Klientë,*

Pas 22 vitesh lider në tregun e sigurimeve shqiptare, SIGAL UNIQA Group AUSTRIA është tashmë një partner i besueshëm dhe kërkon të jetë më shumë se sa thjesht një sigures për klientët, partnerët, punonjësit dhe aksionerët e saj. Ndonjëherë kjo është diçka më e lehtë për t'u thënë sesa për t'u bërë. Rrjedhimisht, jam mëse i kënaqur që sërish edhe gjatë vitit 2021, ne ishim në gjendje të dëshmonim mbi qëndrueshmërinë dhe besueshmërinë tonë. Me rritjen e mëtejshme të primeve, fitimeve, dhe angazhimit tonë në zbatimin e programit të ri strategjik të UNIQA 3.0 "Formësojmë të ardhmen", e UNIQA Insurance Group, ku bën pjesë SIGAL UNIQA, ne po e përforcojmë edhe më tej këtë objektiv.

Tashmë pikat tona të forta – vizioni afatgjatë, fleksibiliteti, përmirësimi i vazhdueshëm i modelit tonë ekzistues të biznesit dhe diversiteti i burimeve tona – na bëjnë më të aftë për t'u përshtatur me zhvillimet e paprecedenta që po përjetojmë si edhe për ta bërë suksesin realitet. Të gjitha këto na ndihmuan të menaxhionim me efektivitet, eficiencë dhe sukses efektet e vazhdueshme të pandemisë COVID-19. Megjithatë, të gjitha këto edhe një herë u testuan këtë herë me situatën aktuale të shkaktuar nga konflikti Rusi-Ukrainë. Ne jemi bërë edhe më të bashkuar si Grup me prezencën tonë në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut, si edhe si pjesë e familjes më të madhe të UNIQA Insurance Group, duke provuar edhe një herë besueshmërinë tonë nën kushte të vështria. Kjo bëhet edhe më e rëndësishme në situata ekstreme siç ishte pandemia COVID-19 dhe tani ajo aktuale në Ukrainë. Ajo që ka më shumë rëndësi është të kujdesemi për njerëzit tanë atje, duke përfshirë punonjësit dhe klientët. Ne do ta kapërcejmë edhe këtë sfidë së bashku.

Diversifikimi i gjerë në tregjet tona dhe linjat tona të biznesit dhe kapacitetet sipërmarrëse lokale promovojnë stabilitetin dhe na lejojnë të ofrojmë mbështetje reciproke. Strukturat tona të mirëorganizuara dhe të decentralizuara në të gjithë



vendin, na lejojnë të reagojmë me shpejtësi me zgjidhje që janë të përshtatura sipas nevojave, kërkesave dhe pritshmërive të klientëve të cilëve iu shërbejmë.

**Në misionin tonë për të qenë më shumë sesa një kompani sigurimi ne kemi zgjeruar modelin e biznesit dhe vlerës së zinxhirit përtej biznesit të sigurimeve.**

**Tashmë pikat tona të forta – vizioni afatgjatë, fleksibiliteti, përmirësimi i vazhdueshëm i modelit tonë ekzistues të biznesit dhe diversiteti i burimeve tona – na bëjnë më të aftë për t'u përshtatur me zhvillimet e paprecedenta që po përjetojmë si edhe për ta bërë suksesin realitet.**

#### **Ristrukturimi i Drejtorisë Qëndrore dhe Degëve në të gjithë Shqipërinë:**

Kur kemi ide të reja, produkte dhe shërbime të reja, inovacione të reja, atëherë nevojiten ndryshime strukurore për t'u përshtatur me kërkesat e reja të diktuara nga koha dhe ndryshimi. Ne kemi realizuar disa ndryshime strukurore gjatë konsideratave tona strategjike në vitin 2021. E para, ne kemi riorganizuar Drejtorinë Qëndrore. E dyta, ne kemi

riorganizuar shpërndarjen dhe hapjen e Degëve të reja të SIGAL UNIQA në të gjithë Shqipërinë.

#### **Më shumë eficiencë:**

Për të arritur këtë ne kemi vijuar me optimizimin e mëtejshëm të modelit të biznesit, duke rritur produktivitetin dhe eficiencën; Kemi thjeshtësuar dhe automatizuar pjesën kryesore të proceseve të punës; Kemi shkëmbyer dhe zbatuar praktikata më të mira; si edhe kemi optimizuar më tej marrjen në sigurim dhe vendosjen e çmimeve.

#### **Më afër klientëve:**

Përmirësimi i modelit të biznesit nëpërmjet adaptimit të mënyrave të reja të qasjes ndaj klientëve dhe pasurimit të gamës së produkteve dhe shërbimeve, të cilat ofrojnë vlerë shtesë për klientët; Kemi rritur vizibilitetin e brandit dhe tërheqjen ndaj produkteve ekzistuese dhe atyre të reja; Kemi përdorur një qasje hibride të shpërndarjes, e cila kombinon kontaktin personal dhe atë dixhital.

#### **Më shumë vlerë të shtuar:**

Në misionin tonë për të qenë më shumë sesa një kompani sigurimi ne kemi zgjeruar modelin e biznesit dhe vlerës së zinxhirit përtej biznesit të sigurimeve; Kemi thelluar fokusin tonë tek menaxhimi i aseteve dhe biznesit të fondeve të pensionit; Dhe kemi punuar më tej me promovimin dhe rritjen e ndërgjegjësimit mbi kujdesin dhe mbrojtjen e riskut.

Për ta përmbyllur dhe duke ju falënderuar për zemërsisht të gjithëve për besimin që keni tek ne, jam krenar për sukseset tona dhe gurët kilometrik që shtrojmë çdo vit në rrugëtimin tonë drejt një të ardhmeje më optimiste dhe më të mirë së bashku.

Miqësisht,

**Avni PONARI**

CEO, SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA

Anëtar i Bordit Mbikëqyrës të SIGAL UNIQA



# Zemra jonë rreh në blu dhe të verdhë

Sulmi ushtarak nga Federata Ruse mbi Republikën e Ukrainës përfaqëson një tragjedi humanitare për ukrainasit dhe një kërcënim për demokracinë dhe paqen në Evropë. SIGAL UNIQA Group AUSTRIA si pjesë e një prej grupeve më të rëndësishme evropiane të sigurimeve në Evropën Qendrore dhe Lindore - UNIQA Insurance Group - ne jemi të shqetësuar rreth situatës aktuale dhe jemi pro solidaritetit me ukrainasit. Ne jemi që të gjithë një komunitet përgjatë të gjithë kufijve kombëtarë dhe kemi treguar solidaritet mbreslënës, veçanërisht në këto kohë të vështira. Para së gjithave dhe më e rëndësishmja, fokusi i Grupit UNIQA ku ne bëjmë pjesë është tek ndihma humanitare.

UNIQA Ukrainë i shërben 1.3 milionë klientëve. UNIQA është numri dy në treg dhe ka një ekip prej rreth 850 punonjësish. UNIQA Ukrainë vazhdon të operojë pavarësisht dëmtimeve të rënda nga lufta ndaj shumë prej zyrave të UNIQA nëpër vend. Që prej fillimit të luftës, punonjësit e UNIQA Ukrainë kanë punuar nën kushte më të vështira nga zyrat e tyre në shtëpi, kanë paguar dëme dhe përfitime me shpejtësi dhe ka ofruar gjithashtu edhe mbështetje psikologjike ndaj klientëve të UNIQA Ukrainë në vend, p.sh., nëpërmjet Qendrës së Telefonatave Mjekësore.

Tashmë UNIQA ka krijuar një ekip krize nën drejtimin e Anëtarëve të Bordit të Grupit të Menaxhimit të

UNIQA, me qëllim për të koordinuar aktivitetet me efikasitet dhe për të përgatitur UNIQA për të gjithë skenarët e mundshëm. Ekipi i krizës është përgjegjës për analizimin e zhvillimeve të situatës dhe për përgatitjen dhe koordinimin e masave ndihmëse.

#### Ndalohe investimet në Rusi

Grupi UNIQA ka vendosur të ndalojë të gjitha investimet në tregun rus të sigurimeve, duke hyrë në fuqi menjëherë si pasojë direkte e luftës. Me këtë vendim, UNIQA po i përgjigjet sulmit ushtarak të Rusisë mbi Ukrainën dhe dhunimet e lidhura me Konventën e Kombeve të Bashkuara.



## 15.8 milionë

klientë

3.7 milionë

klientë në Austri

7.4 milionë

klientë në Evropën Qendrore

4.7 milionë

klientë në Evropën Lindore, Evropën Juglindore dhe Rusi

Numri tregon pozicionin në tregun e sigurimeve në vendin përkatës.

<sup>1</sup> Për tregun e sigurimeve të jetës në Rusi

- Evropa Qendrore (CE)
- Evropa Lindore (EE)
- Evropa Juglindore (SEE)
- Rusia



# Parimet dhe vlerat tona jetomë më mirë së bashku

Që prej vitit 1999, njerëzit na kanë besuar dhe janë siguruar me ne, dhe misioni ynë nuk ka ndryshuar: rreziqet që nuk mund të mbahen vetëm nga individët, mbahen nga të gjitha “shpatullat” e komunitetit tonë. Ne mbështetemi tek rritja e kombinuar e komunitetit tonë për të bërë dallimin në jetën e klientëve tanë dhe për t’i ofruar atyre shërbimet që shkojnë përtej mbrojtjes së pastër. Baza e suksesit dhe potenciali i ynë i ardhshëm është ofrimi i shërbimeve dhe produkteve të klasit të parë për mbi 1 milionë klientët tanë në Shqipëri, dhe më gjerë në Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut dhe ne po ndjekim një kurs rritjeje, duke fuqizuar në mënyrë të konsiderueshme pozicionin tonë në tregun vendas dhe atë rajonal.

#### **Klientët të parët**

Ne jemi të organizuar rreth segmenteve të klientëve tanë tek shitjet me pakicë, sipërmarrjet e vogla, të mesme dhe të mëdha dhe tek bankat. Ne jemi vendosmërisht të fokusuar tek nevojat dhe kërkesat e tyre, duke kërkuar vazhdimisht mendimet e tyre.

#### **Komuniteti**

Ne mbështesim gjithashtu njëri-tjetrin përtej përgjegjësisë tona të përcaktuara për t’i shërbyer klientëve tanë me sa më shumë efektivitet që të jetë

e mundur. Ne jemi të angazhuar për përmirësimin e vazhdueshëm të bashkëpunimit tonë.

#### **Të përgjegjshëm**

Ne marrim përgjegjësitë tona dhe kërkojmë zgjidhjet më të mira dhe më të shpejta për klientët tanë. Ne fokusohemi tek klientët dhe aksioni dhe jo tek burokracia.

#### **Thjeshtësia**

Ne prioritojmë ofrimin e zgjidhjeve të thjeshta, të menjëhershme dhe të sakta. Për

ne bashkëbisedimi dhe diskutimet personale janë kyçe dhe të parat në komunikimet tona me klientët, duke reduktuar komunikimet e shkruara burokratike, por zgjidhjet me veprime konkrete.

#### **Integriteti**

Ne jemi të vendosur ndaj vlerave dhe politikave tona në të gjitha veprimet tona. Komunikimi transparent është pjesë e jetës sonë të përditshme. Ne bëjmë gjithçka që mundemi për të mbajtur premtimet tona.

## Misioni ynë

# Më shumë se sa thjesht një kompani sigurimi

Një kompani shqiptare me standarde evropiane si SIGAL UNIQA Group AUSTRIA e ka të qartë misionin e saj: të paguajë në kohë rekord dëmet dhe të mbrojë qytetarët mbi bazën e kontratave të sigurimit.

Përgjatë 22 viteve punë, SIGAL UNIQA si Grup ka paguar më shumë se 400 milionë euro dëme, shifër kjo që tregon qartë seriozitetin, qëndrueshmërinë financiare dhe përgjegjshmërinë ndaj klientëve të saj.

Vetëm për dy tërmetet e fundvitit 2019, SIGAL UNIQA ka paguar mbi 12 milionë euro dëme për klientët e saj.

Krahas përgjegjshmërisë kontraktuale, SIGAL UNIQA ka dëshmuar përkujdesje maksimale për komunitetin, duke

kontribuar në shëndet, art, kulturë, trashëgimi kulturore, sport, turizëm dhe arsim me miliona euro ndër vite. Vepra të tilla si rikonstruksioni i Teatrit Skampa në Elbasan pas djegies totale, rikonstruksioni i Kinema Millenium Korçë, rikonstruksioni i shtëpisë muze në Korçë e Berat, rikonstruksion shkollash dhe pajisje me mjete shkollore, të gjitha këto mbajnë emrin SIGAL UNIQA.

Sepse e tillë duhet të jetë një kompani, e cila jo vetëm të marrë por edhe duhet t'i japë mbrapsht komunitetit, nëpërmjet investimeve në fusha të ndryshme. Kjo ka qenë motoja jonë si SIGAL UNIQA që prej fillimit dhe do të vazhdojë të jetë edhe për të ardhmen. Sepse ne besojmë që zhvillimi jonë shkon krahas për krahas me zhvillimin e shoqërisë dhe ekonomisë së vendit tonë.

## Çfarë kërkojmë të jemi?

Aktualisht, bota jonë po përballet me sfida madhore: zhvillime dhe ngjarje të tilla si pandemia COVID-19; ndryshimet klimatike dhe demografike; rritja e katastrofave natyrore, rritja e inflacionit, rritja e çmimeve të energjisë elektrike; mungesa e materialeve bruto dhe furnizimeve; rritja e borxheve jo vetëm për kompanitë dhe të gjitha ekonomitë, por për secilin prej nesh; dhe së fundmi lufta brutale dhe agresioni i Rusisë në Ukrainë, në një nga tregjet e UNIQA ku bën pjesë SIGAL UNIQA.

**Pyetja është:**

**Kush ofron siguri në skenarë të tillë?**

**Kujt mund t'i besojmë?**

Kjo është sfida me të cilën po përballemi në SIGAL UNIQA. Sepse siguria ka qenë misioni ynë për më shumë sesa 22 vjet. Ne jemi në krahë të klientëve tanë dhe i ndihmojmë ata të marrin vetë përgjegjësitë e tyre, njëherësh në termat e shëndetit dhe të parandalimit, si edhe në mbrojtjen e pasurive të tyre. Për të mundësuar diçka të tillë në mënyrë të qëndrueshme, ne duhet të vazhdojmë të zhvillohemi. Si bazë dhe guidë për këtë, ne kemi programin e ri strategjik UNIQA 3.0 që prej fundit të vitit 2020 dhe tashmë ne kemi arritur progres të mirë gjatë zbatimit të saj në vitin 2021.

## Bordi Mbikëqyrës



**Andreas Brandstetter**  
Kryetar i Bordit Mbikëqyrës, SIGAL UNIQA  
CEO i UNIQA Insurance Group



**Erhard Busek**  
Zv. Kryetar i Bordit Mbikëqyrës,  
SIGAL UNIQA



**Wolfgang Kindl**  
Anëtar i Bordit Mbikëqyrës,  
SIGAL UNIQA



**Georgios Bartzis**  
Anëtar i Bordit Mbikëqyrës,  
SIGAL UNIQA



**Gerald Mueller**  
Anëtar i Bordit Mbikëqyrës,  
SIGAL UNIQA

# Formësojmë të ardhmen

Në ditët e sotme nuk mjafton më që ne të jemi thjesht një kompani sigurimi. Ne duhet dhe ne gjithashtu kërkojmë të bëjmë shumë më shumë sesa kaq.

## Ofrimi i shërbimeve lider

Objektivi kryesor është ofrimi i shërbimeve lider për një jetë më të mirë. Ambicie të tjera janë ruajtja e pozicionit të lidershit tonë në treg në Shqipëri, dhe më gjerë në Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut, për të qenë efektiv nga pikëpamja e kostove dhe fitimit, dhe për të pozicionuar veten si punëdhënësi më tërheqës në këtë industri.

## Objektiva ambicioze

Dy pikat kryesore të veprimit në zbatim të këtij vizioni janë optimizimi i biznesit kyç – e ndarë rishtazi në segmentet e klientëve të Shitjeve me Pakicë, Ndërmarrjeve të Mesme dhe të Vogla, Korporatave dhe Bankave, nga njëra anë, dhe eksplorimin e segmenteve novatore të biznesit, modelit dixhital të biznesit dhe zhvillimin e një ekosistemi në sektorin e shëndetit, në anën tjetër.

## Përgjigjja ndaj sfidave aktuale

Vizioni ynë është mbrojtja dhe përmirësimi i shëndetit dhe mirëqenies së klientëve tanë në mjedisin ku ne operojmë. Për të arritur këtë, ne jemi fokusuar tek orientimi maksimal tek klientët tanë, duke përmbushur vazhdimisht nevojat dhe pritshmëritë e tyre, si edhe zhvillimin e mëtejshëm të segmenteve të biznesit, të cilat na mundësojnë të kemi më shumë pika kontakti pozitive me ta. Në të njëjtën kohë, ne po fokusohemi gjithnjë edhe më shumë tek qëndrueshmëria në të gjitha aktivitetet tonë.

## Parime të qarta

Në marrëdhënien tonë me klientët tanë, por gjithashtu edhe në vetë kompani, ne kërkojmë gjithmonë që të motivojmë dhe frymëzojmë, dhe të gjitha veprimet tona udhëhiqen nga pesë parime: klientët të parët, thjeshtësia, përgjegjshmëria, integriteti dhe komuniteti.



Bordi Drejtues i Grupit SIGAL UNIQA  
(Nga e majta në të djathtë) Saimir Dharmo (CEO i SIGAL UNIQA Group Austria Kosova), Alma Totokoçi (Zv. Drejtore e Përgjithshme e SIGAL UNIQA Group Austria), Avni Ponari (CEO i Grupit SIGAL UNIQA Group Austria), Edvin Hoxhaj (Drejtor i Përgjithshëm i SIGAL Life UNIQA Group Austria), Driton Azizi (Drejtor i Përgjithshëm i UNIQA Maqedoni e Veriut) dhe Elvis Ponari (Administrator i Përgjithshëm i Fondi të Pensioneve Vullnetare SIGAL Life UNIQA Group Austria)

## Struktura e Grupit SIGAL UNIQA



86.9%

UNIQA Insurance Group



Aksionerët tanë

13.1%

Investitorë vendas



Kush është SIGAL UNIQA

# Kompania lider në tregun e sigurimeve në Shqipëri

Ne jemi kompania lider në tregun e sigurimeve në Shqipëri, ku udhëheqim tregun vendas që prej vitit 2002, duke zotëruar mesatarisht 30% të tregut.

Grupi SIGAL UNIQA është një familje e madhe që numëron mbi 2,100 punonjës dhe agentë, të cilët u shërbejnë 1 milion klientëve në tre shtete: Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut.

SIGAL UNIQA është ndër grupet më të mëdhenj financiar në rajon, i përbërë nga 7 kompani sigurimesh dhe 1 fond pensioni privat dhe zotëron 121.2 milionë Euro asete, numëron mbi 81 milionë Euro prime të shkruara për vitin 2021 dhe rreth 400 milionë Euro dëme të paguara ndër vite.

Suksesi dhe arritjet e kompanisë u takojnë mbi të gjitha klientëve të cilët që automjetin, shëndetin, pronën etj., ja kanë besuar SIGAL UNIQA-s.

Sepse SIGAL UNIQA ofron mundësi të reja aty ku të tjerët nuk i shohin, ndaj është gjithmonë një hap përpara. E para në ofrimin e produkteve novatore, të thjeshta, të shpejta dhe pa asnjë kosto shtesë. Qëllimi i kompanisë është të përmirësojë shërbimin ndaj klientëve duke u reduktuar atyre kohë dhe kosto.


Nën slloganin “Jetojmë më mirë së bashku”, SIGAL UNIQA Group AUSTRIA do të vijojë të mbetet partneri kryesor i qytetarëve për një jetë më të mirë dhe të sigurt.

Kush është UNIQA

# Një prej kompanive më të mëdha të sigurimeve në Evropën Qëndrore dhe Lindore

Grupi UNIQA është një nga kompanitë lidere të sigurimit në tregjet e saj kyçe në Austri dhe Evropën Qëndrore dhe Lindore. Rreth 22,400 punonjës dhe partnerë ekskluzivë shitjesh i shërbejnë thuajse 16 milionë klientëve në 18 vende. UNIQA është grupi i dytë më i madh i sigurimeve në Austri, ku zë rreth 21 për qind të tregut. Në rajonin në rritje në EQL, është e pranishme në 15 tregje: Shqipëri, Bosnje dhe Hercegovinë, Bullgari, Kroaci, Republikën Çeke, Hungari, Kosovë, Mal të Zi, Maqedoninë e Veriut, Poloni, Rumani, Rusi, Serbi, Sllovaki dhe Ukrainë. Për më tepër, kompanitë e sigurimit në Zvicër dhe Lihtejshtajn janë gjithashtu pjesë e Grupit UNIQA.

% sipas produkteve ...



... në tregun në Austri dhe në Evropë Qendrore e Lindore

## UNIQA 3.0 iniciativat financiare

Iniciativat kryesore financiare	Treguesit e performancës operacionale	2020	2021	2025
<b>Rritje</b> 1. Austri - Udhëheqja në treg 2. Evropa Qëndrore dhe Lindore (EQL) - Nr. 5 në treg 3. Segmente të reja biznesi - SanusX	Rrijta e primeve	3.6%	14.2%	o 3% p. a.
<b>Fitimet</b> 4. Reduktimi i shpenzimeve në Austri dhe EQL 5. Rritja e përfitueshmërisë - Sigurimet e pasurisë 6. Stabilizimi i portofolit - Sigurimi i Jetës	Raporti i kombinuar Raporti i shpenzimeve Kthimi nga kapitali	97.8% 29.4% 0.6%	93.7% 27.4% 9.5%	< 94% ~ 25% 8-10%
<b>Cilësia</b> 7. Pozicioni i fortë i aftësisë paguese 8. Pagesë tërheqëse e dividendit 9. Ofruesi më i mirë i shërbimit	Raporti i aftësisë paguese Kënaqësi të konsumatorëve Austri dhe EQL	170% 4.2 4.4	196% 3.9 4.6	> 170% ≥ 4.5 ≥ 4.5

## UNIQA 3.0 – qasje gjithëpërfshirëse





# Ngjarjet kryesore 2021



## Takimi rajonal i grupit SIGAL UNIQA

SIGAL UNIQA Group AUSTRIA zhvilloi në datat 25-26 qershor 2021 Takimin Rajonal të grupit, me fokus analizën financiare të tre kompanive SIGAL UNIQA në Shqipëri-Kosovë-Maqedoni e Veriut, sfidat dhe ndryshimet që solli pandemia e Covid 19 si dhe objektivat për 6-mujorin e dytë të vitit 2021 dhe objektivat më afatgjatë për vitin 2022. Në analizën financiare, CEO i SIGAL UNIQA për tre shtetet, z. Avni PONARI, vuri në dukje ndikimin që pandemia pati në sektorin e sigurimeve, ku përgjatë mbylljes që patën 3 vendet, sigurimet patën një rënie të ndjeshme, por menjëherë më pas filloi rimëkëmbja, duke arritur përgjatë këtij viti sërish në nivelet e para pandemisë. SIGAL UNIQA ishte e vetmja kompani, e cila, edhe pse ka paguar dëmet më të mëdha të tregut, dëme që erdhën si pasojë e dy tërmeteve të 2019-ës që u shtrinë përgjatë 2020-ës si dhe të dëmeve që erdhën si pasojë e pandemisë nga Covid 19 duke paguar të gjitha kërkesat për dëmshpërblim të klientëve të siguruar më shëndet privat, sërish SIGAL UNIQA ka ruajtur qëndrueshmërinë e saj financiare dhe ka mbajtur vendin e liderit të tregut me një diferencë të madhe nga kompania që renditet e dyta në treg. SIGAL UNIQA, produkte dhe shërbime novatore përgjatë 2020-ës. SIGAL UNIQA ishte e vetmja kompani në Shqipëri dhe rajon e cila hodhi në treg sigurimin nga Covid 19, me një çmim simbolik por me përfitime të mëdha për qytetarët.







Z. Avni Ponari i ftuar në javën evropiane të start-up-eve 2021

**Z. Avni Ponari i ftuar në javën evropiane të start-up-eve 2021**

Z. Avni Ponari, Drejtor i Përgjithshëm i SIGAL UNIQA Group AUSTRIA, ishte i ftuar më 14 tetor 2021 në "Javën Evropiane të Start-Up-eve 2021", organizuar nga Triple City, për të folur mbi rrugëtimin e tij në sipërmarrje, themelimin e kompanisë SIGAL UNIQA, investimet ndër vite etj.

**Hapja e degës së re nr. 6 të sigal uniqa, tiranë**

Rrjetit të 1,200 zyrave të SIGAL UNIQA Group AUSTRIA i shtohet një Zyrë e Re - Dega Nr. 6 tek Fresku, në Tiranë. Hapja e kësaj Dege vjen në përputhje me objektivat e strategjisë së zgjerimit të Kompanive të Grupit SIGAL UNIQA. Pranë këtyre zyrave klientët e SIGAL UNIQA mund të kryejnë të gjitha shërbimet për të gjitha produktet e sigurimit dhe anëtarësimin në Fondin e Pensioneve Private të SIGAL UNIQA.



**Zyrat e reja të sigal uniqa në ish-blok transferohen në rrugën e elbasanit**

Në këtë pikëndodhje transferohet zyra e SIGAL UNIQA që ndodhej në ish-Blok, në rrugën Ibrahim Rugova. Pranë këtyre zyrave mund të kryhen shërbimet për të gjitha produktet e sigurimit që nga blerja e të gjitha llojeve të siguracioneve



deri tek marrja e dëmshpërblimit, në rast aksidenti apo dëmtim prone, biznesi etj.

**Hapja e degës nr.2 të SIGAL UNIQA, korçë**

Gjatë inagurimit të Degës Nr. 2 për Shitjen e Produkteve dhe Kryerjen e Shërbimeve ndaj Klientëve në Qytetin e Korçës, një investim prej 350,000 eurosh, morën pjesë Z. Sotiraq Filo, Kryetar i Bashkisë së Korçës, Z. Avni Ponari, Drejtor i Përgjithshëm i SIGAL UNIQA Group AUSTRIA në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut, dhe Drejtues të Lartë të SIGAL UNIQA.



"Duke qenë se, qyteti i Korçës është qyteti më i madh i Shqipërisë jug-lindore dhe një qendër e rëndësishme kulturore dhe industriale, klientët tanë në qytet, në rrethina dhe në akset jug-lindore mund të na kontaktojnë me shumë më shumë lehtësi, shpejtësi dhe efektivitet për të marrë produktet dhe/ose shërbimet për të cilat ata kanë nevojë," shpjegoi më tej Z. Ponari.

**Hapja e zyrave të reja të UNIQA Life sha Shkup**

Me ratstin e 18 viteve nga themelimi i UNIQA SHA si dhe 11 vite të UNIQA Life SHA Shkup me 28 dhjetor u organizua inagurimi i zyrave të reja qendrore në bul. Ilinden nr.1 Shkup. Inagurimi me prerjen e shiriti për hapjen solemne të zyrave të reja u bë nga ana e Presidentit të Bordit mbykqyrës SIGAL UNIQA GRUP



Hapja e zyrave të reja të UNIQA Life sha Shkup

Shqipëri, Maqedonia e Veriut dhe Kosovë Z.AVNI PONARI së bashku me Ambasadorin e Republikës së Austrisë Dr. Georg Woutsas, Drejtori gjeneral nga UNIQA Maqedoni Z. Driton Azizi si dhe Drjetoresha e UNIQA Life ZNJ. Aleksandra Shkëmbi Antovska.

**Trajnimi i burimeve njerëzore**

Përgjatë gjithë vitit, i gjithë stafi i SIGAL UNIQA Group AUSTRIA ka vazhduar trajnimin dhe kualifikimin profesional nga Drejtoria e Përgjithshme mbi të gjitha produktet, shërbimet dhe inovacionet e sigurimeve. Trajnimet u mbajtën nga departamentet sipas produkteve që ata menaxhojnë si dhe trajtimi i dëmeve, që zë një vend të rëndësishëm në punën e një kompanie sigurimesh. SIGAL UNIQA i kushton rëndësi të veçantë trajnimit dhe zhvillimit të stafit, ndaj dhe kontribuon vazhdimisht për këtë, duke e trajnuar stafin jo vetëm në Shqipëri por edhe në Vjenë, në zyrat e UNIQA Group.

**SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA I Akordohet çmimi "superbrands albania's choice 2019/2020" nga prestigjiozia "superbrands international"**

SIGAL UNIQA Group AUSTRIA i akordohet Çmimi "SUPERBRANDS ALBANIA'S CHOICE 2019/2020" nga prestigjiozia "SUPERBRANDS INTERNATIONAL", i cili i ofrohet brandeve më të dalluara në fushën e tyre - për SIGAL UNIQA, në industrinë e sigurimeve në Shqipëri - si edhe si një tregues i qartë për pozicionin solid të brandit, prestigjin e biznesit të përfaqësuar, kënaqësinë, besimin dhe garancinë e



klientëve. SIGAL UNIQA e merr këtë Çmim për të disatën herë rradhazi. SIGAL UNIQA falenderon të gjithë klientët e saj për besimin e tyre tek ne. Ne jemi mirënjohës dhe krenar për shërbimin 'par excellence' ndaj jush.

**SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA renditet në top 100 kompanitë e sigurimit në europën juglindore**

Sipas një rënditjeje të publikuar nga media "SEE News", SIGAL UNIQA Group AUSTRIA renditet në vendin e 62 në Europën Juglindore sa i përket kompanive të sigurimit. Sa i përket Shqipërisë, SIGAL UNIQA është kompania numër 1 e Sigurimit, duke lënë pas Albsig që renditet në vendin e 70, SIGMA në të 81-in, Eurosig 82 dhe Intersig 97. "SEE TOP 100 siguresit" është një renditje e siguresve më të mëdhenj në

Europën Juglindore (pa përfshirë risiguresit) përsa i përket primeve të shkruara bruto për vitin 2020.

**SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA renditet mes top 100 bizneset në shqipëri**

Besimi i shqiptarëve shpërblen kompaninë lidere të sigurimeve. Revista Monitor gjatë publikimit të renditjes së kompanive më të mëdha, renditi SIGAL UNIQA në vendin e 66-të.





# Ngjarjet kryesore nga UNIQA Insurance Group



## UNIQA Insurance Group bëhet anëtare e "net zero asset owner alliance"

Gjigandi austriak i sigurimeve "UNIQA Insurance Group" është tashmë anëtare e 'Net Zero Asset Owner Alliance'. Në fund të tetorit, UNIQA Insurance Group u bë kompania e parë e sigurimeve në Austri që iu bashkua aleancës së investitorëve global në sektorin bankar dhe të sigurimeve të iniciuar nga Kombet e Bashkuara. UNIQA dhe më shumë sesa 60 anëtarë të tjerë janë bashkuar nga një objektiv ambicioz: "Për të bashkuar forcat në investimet e qëndrueshme për të vepruar shpejt në zbatimin e vazhdueshëm të targetit të Parisit në rrugën drejt 1.5 gradë". "Ne jemi krenarë që jemi pjesë e Aleancës për ta kthyer angazhimin tonë ndaj neutralitetit të klimës në veprim dhe për të reduktuar emisionet në net-zero deri në fund të vitit 2040. Ne mbështesim aleancën dhe ndjejmë se jemi të mirëvendosur në një komunitet kolegëz të angazhuar", është shprehur Andreas Brandstetter, CEO i UNIQA Insurance Group.

## CEO Andreas Brandstetter zgjidhet "Menaxheri i vitit" në Austri

"Industrie Magazin", si çdo vit, ka zgjedhur 1000 menaxherët më të mirë në Austri. Renditja bazohet në të dhënat e regjistrimit tregtar të të gjithë personave në 5000 kompanitë industriale të Austrisë me qarkullimin më të lartë, dhjetë institucionet më të mëdha të kreditit – sipas totalit të aktiveve – dhe

fondacionet private të lidhura me to. Në listë janë përfshirë të gjithë personat aktivë operativë në këto kompani, si anëtarët e bordit, drejtorët menaxhues dhe anëtarët e bordit mbikëqyrës. Ashtu si vitet e kaluara, në renditje nuk janë përfshirë politikanë, menaxherë të shëndetësisë apo juristë. Këtë vit, Andreas Brandstetter, CEO i UNIQA Insurance Group, zuri vendin e parë në renditje. Krahasuar me një vit më parë është përmirësuar me dy vende.

## Samiti vjetor i kulturës "ne jemi një komunitet"

Çdo ditë, ne mbështesim klientët tanë në një sërë mënyrash, ne mënyrë që ata të marrin vendime që i përmirësojnë jetët e tyre. Në vitin 2021, UNIQA mbajti Samitin Vjetor të Kulturës, me më shumë se sa 150 kolegë nga vende dhe departamente të ndryshme të cilët na u bashkuan për të diskutuar se si të zhvillojmë një nga brandet më frymëzuese dhe më të kujdesshme.



# Përgjegjësia sociale



## MBËSHITESIM PROJEKTET SHËNDETËSORE

### Klinika Lëvizëse "SIGAL UNIQA" shkon në Shkodër

Nën moton "Jetojmë më mirë së bashku", SIGAL UNIQA Group AUSTRIA ka ndërtuar dhe e vë në dispozicion të banorëve të zonave dhe qytete të ndryshme të Shqipërisë, Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut, Klinikën Mjekësore Lëvizëse "Vital Truck", e vetmja e këtij lloji në vendin tonë dhe jo vetëm. "Klinika Lëvizëse Mjekësore SIGAL UNIQA" pati Shkodrën si ndalesën e saj. Në datat 4 dhe 5 nëntor, "Vital Truck" ishte prezent në dy zona të Bashkisë Shkodër, për t'ju ofruar banorëve vizita dhe kontrolle falas nga mjekë të specializuar.

## MBËSHITESIM AKTIVITETET SPORTIVE

### Rikthehet Basketboli, SIGAL UNIQA e mbështetet gjithmonë

Federata Shqiptare e Basketbollit në bashkëpunim dhe me mbështetjen e vazhdueshme ndaj sportit nga SIGAL UNIQA Group AUSTRIA, si edhe në kuadër të zbatimit të masave kundër përhapjes së COVID-19 dhe ruajtjes së distancës, vijoi më 27 mars 2021, me aktivitetet sportive me ndeshjen e rradhës së basketbollit me pjesëmarrjen

e ekipeve Teuta, Tirana, Galaktikking dhe Beslidhja, me fitues Teuta Vajza U16.

### Fundjavat 3x3 StreetBasket

Federata Shqiptare e Basketbollit në bashkëpunim dhe me mbështetjen e vazhdueshme ndaj sportit nga SIGAL UNIQA Group AUSTRIA, vijoi në qershor dhe dhjetor 2021, me aktivitetet sportive me ndeshjet e rradhës së basketbollit 3x3 në Pogradec dhe Tiranë, ku morën pjesë 6 ekipe me meshkuj me fituese Ekipin e Pogradecit dhe Basket Tirana për meshkuj me fitues Ekipin EpidamnSquad.

## SIGAL UNIQA gjithmonë në krahë dhe në mbështetje të më të mirëve!

Kompania kampione e sigurimeve në trojet shqiptare, SIGAL ka vazhduar të jetë besnike ndaj skuadrës SIGAL Prishtina edhe për edicionin e ri. Marrëveshja u arrit me datë 16 qershor 2021 në një takim në mes CEO së SIGAL UNIQA z. Avni Ponari dhe Presidentit të Klubit Burim Maraj.

## MBËSHITESIM TRASHËGIMINË KULTURORE, ARTIN DHE KULTURËN

### Orkestra e Harqeve të Klubit të Artit SIGAL koncert me rastin e festave të fundvitit

Orkestra e Harqeve të Klubit të Artit SIGAL zhvilloi koncert me rastin e festave të fundvitit, në Amfiteatrin e Durrësit.



Orkestra e Harqeve e SIGAL UNIQA koncert në Valbonë



Orkestra e Harqeve të Klubit të Artit SIGAL koncert me rastin e festave të fundvitit



Orkestra e Harqeve e SIGAL UNIQA koncert në Vlorë

Koncerti u transmetua edhe në Radio Televizionin Shqiptar, në RTSH Muzikë. Orkestra e Harqeve, e përbërë nga 15 instrumentistë profesionistë, është pjesë e Klubit të Artit dhe Kulturës SIGAL, i cili u themelua në vitin 2009 me iniciativë të Avni Ponarit, dhe, që prej asaj kohe, ka shërbyer për promovimin e shumë artistëve të rinj dhe të afirmuar në fushën e letërsisë, muzikës dhe arteve pamore. Përgjatë këtyre viteve në Klubin e Artit janë zhvilluar dhjetëra aktivitete kulturore ndër të cilat ekspozita pikturë, mbrëmje muzikore, portrete artistësh, promovime librash dhe seminare me tematika të ndryshme.

#### Orkestra e Harqeve e SIGAL UNIQA koncert në Valbonë

Orkestra e Harqeve e SIGAL UNIQA zbrit në Valbonën e bukur, të bekuar, në perlën e përgjeshme të Tropojës dhe të Shqipërisë. Malet ende të veshura me dëborë të Valbonës mesmerizuese, të një oazi bukurie të pazakonshme u mbuluan këtë fundjavë me meloditë magjike me pjesë të përzgjedhura muzikore nga Prenk Jakova, Ylli Ramzoti, Çesk Zadeja, si edhe nga Johann Sebastian Bach dhe Antonio Vivaldi, në një koncert special të Orkestrës së Harqeve të SIGAL UNIQA.

#### Orkestra e Harqeve e SIGAL UNIQA koncert në Vlorë

Me rastin e Ditës Botërore të Muzeve, Orkestra e Harqeve të SIGAL UNIQA Group AUSTRIA, më 18 maj 2021, zhvilloi një koncert në Hollin Veror të Muzeut Kombëtar të Pavarësisë, Vlorë. Nën dirijimin e Mjeshtrit Ermir Dizdari dhe me pjesëmarrjen e një grupi profesional instrumentistësh, koncerti tërhoqi vëmendjen dhe nxiti interesin e qytetarëve për muzikën Klasike.

#### Muzeu i SIGAL UNIQA edhe në versionin virtual

SIGAL UNIQA është e para dhe e vetmja kompani sigurimesh në Shqipëri dhe rajon, e cila ka ndërtuar një muze. I vendosur në godinën e zyrave qendrore, muzeu i SIGAL UNIQA tregon gjithë historikun e kompanisë, që prej fillimit të saj më 22 shkurt 1999 e deri më sot. Ky muze është një dëshmi jo vetëm e kompanisë tonë, por edhe e tregut të sigurimeve në tërësi, konsideruar faktin që SIGAL UNIQA është ndër pionerët e sigurimeve në Shqipëri. Muzeu mund të vizitohet fizikisht por së fundmi edhe virtualisht.



Muzeu i SIGAL UNIQA edhe në versionin virtual

#### SIGAL UNIQA sponsor i Këngës Magjike

SIGAL UNIQA vlerëson artin dhe kulturën, dhe mbështet çdo vit evente dhe artistë të ndryshëm. Në kuadër të përgjegjësisë sociale, numërohen qindra aktivitete kulturore ndër vite të realizuar falë mbështetjes financiare të kompanisë më të madhe të sigurimeve në Shqipëri, SIGAL UNIQA Group

Austria. Edhe këtë vit SIGAL UNIQA mbështet festivalin "Kënga Magjike", me qëllim promovimin jo vetëm të talenteve tashmë të afirmuara të muzikës por edhe artistët e rinj që marrin pjesë për herë të parë.

#### SIGAL UNIQA sponsor i Festivalit të Këngës 2021

SIGAL UNIQA Group AUSTRIA ishte mbështetës i Edicionit të 60-të të Festivalit të Këngës 2021 të Radio Televizionit Shqiptar në mbështetje të muzikës moderne shqiptare.

#### MBËSHTESIM EDUKIMIN DHE PUNËSIMIN

#### Risia e kulturës/ Përditësimi me librat më në zë vetëm me një shkarkim, Audiobooks

SIGAL UNIQA Group AUSTRIA si kompania lider e sigurimeve në vend, gjithmonë e angazhuar ndaj përgjegjësisë sociale ndaj komunitetit - mbështetës krenar të kulturës, edukimit, sportit dhe mjedisit. Një ndër projektet tona më të suksesshme është – AUDIOBOOKS.AL – platforma e parë dixhitale e librave audio në shqip, duke numëruar mbi 200 tituj dhe 50,000 përdorues.

#### SIGAL UNIQA pjesë e Panairit Ndërkombëtar të Tiranës

"One Balkan, Stronger Balkans", SIGAL UNIQA pjesë e Panairit Ndërkombëtar të Tiranës.

#### MBËSHTESIM MJEDISIN

#### Avni Ponari dhe Ambasadori i Japonisë mbjellin pemë për kryeqytetin

Drejtori i Përgjithshëm i SIGAL UNIQA Group AUSTRIA, Avni PONARI dhe Ambasadori i Japonisë në Shqipëri, TAKADA Mitsuyuki morën pjesë në mbjelljen e një numri të konsiderueshëm pemësh qershie në qytetin e Tiranës. Pemët u mbollën në Parkun Rinia Tiranë, i rikonstruktuar së fundmi. Ky aktivitet u pasqyrua edhe nga mediat vizive dhe ato online. Më herët, Ish-Ambasadori i Japonisë Makoto Itto, së bashku me Avni Ponarin, në cilësinë e Konsullit të Përgjithshëm të Nderit të Japonisë në Shqipëri, morën pjesë në mbjelljen e pemëve të qershisë nga qeveria Japoneze në kodrat e liqenit të Tiranës, për t'ju bashkangjitur kështu projektit të gjelbërimit të kryeqytetit.







Botimi Special "22 vite SIGAL UNIQA". Në kuadër të 22 vjetorit të themelimit të SIGAL UNIQA, kompanisë më të madhe të sigurimeve në Shqipëri, u realizuan disa publikime të veçanta. "SIGAL UNIQA 22 vite, kompania që kontribuon në çdo sfidë" u quajt revista e ideuar dhe publikuar online me rastin e 22-vjetorit. Revista mbart të dhëna dhe informacione të kompanisë që prej themelimit të saj, bashkëpunimet, mbështetjet dhe financimet që SIGAL UNIQA ka realizuar ndër vite, intervista të drejtuesve dhe shkrime dhe opinione mbi tregun e sigurimeve dhe një rrëfim të Drejtorit të Përgjithshëm, Z. Avni PONARI, se si e ka ideuar dhe themeluar SIGAL 22 vite më parë.

### Z. Avni Ponari, Drejtor i Përgjithshëm i SIGAL UNIQA i ftuar në:

- Intervistë për Revistën Monitor "Nëse shteti thotë 'i paguaj unë të gjitha', qytetarët do të vazhdojnë të mos sigurohen". "Unë nuk jam për shtimin e sigurimeve të detyrueshme, por për evidentimin e qartë të bazës ligjore, në bazë të së cilës, qytetari të zgjedhë të sigurohet, ose të mos sigurohet, dhe ku interesi i qytetarëve të jetë i mbrojtur. Pra, jo sigurim i detyrueshëm, por përgjegjësi e siguruar. Nëse një individ zgjedh të mos sigurohet, ai do të jetë i detyruar të marrë vetë kostot e dëmeve që mund t'iu shkaktojë të tjerëve ose të dëmeve që mund të pësojë vetë dhe jo të themi, mos u siguroni sepse ua zgjidh shteti hallet. Jam për këtë lloj fryme, që secili të mbajë përgjegjësi ligjore dhe financiare për dëmet, jo për t'i bërë domosdoshmërisht sigurimet të detyrueshme", u shpreh Z. Ponari.

- Emisionin A2 Business, në A2 Televizion mbi "Pandemia goditi bizneset por krijoi dhe mundësi të reja" për të diskutuar mbi: Ekonominë post-covid tek bizneset dhe qytetarët; Si u ndikua tregu i sigurimeve nga pandemia dhe sa u ndërgjegjësuam qytetarët për të siguruar shëndetin, jetën dhe pasuritë e tyre.

- RTSH mbi "Ç'do të ndodhte nëse do të ishim të siguruar të gjithë nga tërmetet dhe pandemitë?" për të diskutuar mbi: Çfarë bëjmë ne si qytetarë për të mbrojtur shëndetin, pronën dhe pasurinë tonë?; Në çfarë situatë do të ishim nëse do të

ishim të siguruar të gjithë? etj.

- Emisionin "E diela shqiptare", në TV Klan për të diskutuar mbi: Sigurimin e shëndetit, sigurimin e pasurisë, të apartamentit, pensionet private, sigurimin e jetës e plot gjëra nga bota e sigurimeve. "Teleshëndeti", kjo risi botërore që ka tërhequr miliona në të gjithë botën, sepse tashmë e ke mjekun me vete në 24/7, kudo ku ndodheni, pa orar, merrni këshillën nga mjeku të sjellë vetëm nga SIGAL UNIQA Group AUSTRIA.

Emisionin "Hipokrati", në Top Channel për të diskutuar mbi: Pse duhet të kemi një sigurim privat shëndeti?; Çfarë përfitojmë nga sigurimi privat i shëndetit tek SIGAL UNIQA?; A kanë mundësi familjet shqiptare që të kenë një sigurim privat shëndeti?; Çfarë është shërbimi modern dhe bashkëkohor i Telemjekësisë, i realizuar nëpërmjet aplikacionit "Teleshëndet", nga Kompania Sigal?; Sa ndikon Telemjekësia në kostot e përkujdesit dhe trajtimit mjekësor të një individi? etj.

- Intervistë në gazetën Koha Jonë mbi "POOL-ET" në sigurime, domosdoshmeria e ndarjes së rrishtit në sigurime. Aftësia për të ndarë me efikasitet rreziqet midis kompanive nga katastrofat natyrore dhe pandemitë dhe peshën e tyre në një ekonomi është thelbësore për mirëqenien dhe rritjen e ekonomisë. Një ekonomi e shëndetshme sot në të gjithë botën nuk mund të imagjinohet pa industrinë e sigurimeve, që ndryshe konsiderohet edhe shtylla e katër e ekonomisë së një vendi.

- Intervistë në Revistën Monitor mbi "Sigal: Zbatimi i bonus-malus në kushtet e sotme është i vështirë". Avni Ponari, Drejtor i Përgjithshëm i Sigal UNIQA Group AUSTRIA dhe kryetar i Shoqatës së Siguruesve Shqiptarë, mendon se aplikimi i sistemit bonus-malus në kushtet e tregut shqiptar është i vështirë. Sipas tij, tregu ka problematika të shumta, të lidhura me numrin e lartë të mjeteve të pasiguruara, mungesën e besueshmërisë në përcaktimin e përgjegjësve të aksidenteve apo mungesën e bazave të detajuara të të dhënave, që do të mundësonin përcaktimin e primeve sipas faktorëve të rrezikut.

## Produktet, shërbimet dhe inovacionet e reja dixhitale

Ne jemi aty për klientët tanë kudo ku ata kanë nevojë për ne!

Ne jemi fuqimisht të fokusuar dhe të angazhuar për t'i sjellë produktet dhe shërbimet tona përmes aksesit dixhital në kohë reale, sa më thjeshtë dhe me një klikim për të gjithë klientët tanë kudo ku ndodhen. Objektivi ynë është që të investojmë për klientët tanë në teknologjitë dixhitale për të cilat ne besojmë se do t'i bëjë shërbimet tona më të shpejta dhe më eficiente. Për të arritur këtë ne jemi vigjilentë ndaj të gjitha tendencave potenciale të reja të tregut duke i garantuar klientëve tanë trapolinën teknologjike të së ardhmes. Ne punojmë me një ekip të dedikuar dixhital vetëm për këtë qëllim. Ata janë frontiera jone drejt së ardhmes tonë të përbashkët dixhitale. Vizioni dhe modeli ynë përkon me ambicien tonë drejt suksesit. Ne kemi filluar që të shkelim në këtë rrugë të përbashkët duke prezantuar:

### Kasko + GPS falas

Përgjatë muajit prill, SIGAL UNIQA, ofroi sigurimin Kasko me bonus sistemin GPS.

Cilido klient që blinte siguracionin Kasko tek SIGAL UNIQA përfitonte falas edhe sistemin e gjurmimit dhe monitorimit të automjetit, GPS. Me anë të sistemit GPS mund të përcaktoni vendndodhjen e automjetit dhe në çdo kohë do të keni informacion për: Itinerarin ditor të lëvizjes së mjetit; Rruga e përshkruar (route) nga mjete gjatë çdo intervali kohor; Përlllogaritje e sasisë së karburantit të konsumuar për çdo lëvizje; Kohën e qëndrimit ndezur apo fikur; Shpejtësitë e lëvizjes së tij; Geofencing (zonat e lejuara për lëvizjet e mjeteve) etj.

### Risia më e fundit "Teleshëndet"

Më 27 korrik, në ambjentet e Drejtorisë së Përgjithshme të SIGAL UNIQA Group AUSTRIA në Tiranë, u zhvillua një mbledhje ku në fokus ka qenë shërbimi më i fundit që ofron kompania, Teleshëndet. Gjatë mbledhjes, u diskutua për të gjitha funksionalitetet teknike të aplikacionit dhe mbi modifikimet e kërkuara për mirëfunksionimin e tij. Po ashtu u diskutua në lidhje me statusin dhe numrin e dosjeve pezull nga shëndeti privat. Hedhja e të dhënave nga spitalet/klinikat private (problemet dhe çfarë duhet ndryshuar në portal). Si dhe u diskutua strategjia e marketingut të TeleShëndetit.



### Paketa e sigurimit "Jetë Plus"

SIGAL UNIQA Group Austria, kompania më e madhe dhe e besuar e sigurimeve, nëpërmjet siguracionit "Jetë Plus" sjell një mundësi unike për të marrë shërbime mjekësore në spitalet më të mira në Botë, nëse diagnostikoheni me një sëmundje serioze.

Kjo policë sigurimi mundëson:

- Konfirmimi i diagnozës tuaj nga mjekë të huaj
- Ndërhyrja kirurgjikale dhe trajtimi jashtë vendit
- Çdo procedurë që ju duhet për të qenë të sigurt se po merrni shërbimin mjekësor më të mirë në botë, pa u shqetësuar për organizmin apo për ta paguar.

Cilat Sëmundje mbulon kjo policë sigurimi?

- Tumoret malinje (kanceri)
- Ndërhyrjet kirurgjikale në zemër (by pass dhe riparim ose zëvendësim i valvulave koronare)
- Ndërhyrjet kirurgjikale në kokë
- Ndërhyrjet kirurgjikale në shtyllën kurrizore
- Transplantet nga një dhurues i gjallë

A i mbulon shpenzimet jashtë spitalit? PO

- Procedura e gjetjes dhe pagesa e biletës së udhëtimit vajtje-kthim për pacientin dhe një të afërm që e shoqëron
- Procedura e gjetjes dhe pagesa e hotelit për pacientin dhe një të afërm që e shoqëron
- 100 euro në ditë për çdo ditë qëndrimi jashtë vendit

### SIGAL UNIQA ngre Qendrën e Asistencës për Klientët


SIGAL UNIQA Group AUSTRIA, kompania lider në tregun e sigurimeve në Shqipëri dhe rajon, i jep një rëndësi të veçantë shërbimit ndaj klientit. Për t'i ardhur sa më mirë dhe sa më shpejt në kohë kërkesave të tyre, SIGAL UNIQA ka ngritur Qendrën e Asistencës për Klientët. Për çdo pyetje apo paqartësi që mund të ketë, klienti mund të kontaktojë 24 orë në ditë, 7 ditë të javës me specialistët e SIGAL UNIQA përmes Whatsapp-it në numrin: +355 68 606 2829, numrit fiks: +355 4 22 333 08, përmes rrjeteve sociale (Facebook, Instagram, LinkedIn) si dhe në web-chatin e faqes zyrtare të kompanisë [www.sigal.com.al](http://www.sigal.com.al).

# TREGU I SIGURIMEVE NË RAJON

## SHQIPËRI


### Tregu i sigurimeve jo-jetë

Tregu i sigurimeve të jo-jetës, në të cilin operojnë 8 kompani, u udhëhoq nga SIGAL UNIQA e cila zotëroi 25.88 % të tregut. SIGAL UNIQA renditet gjithashtu e para edhe për pagesën e dëmeve duke paguar 34.83 % të dëmeve.




### Tregu i sigurimeve të jetës

Që prej disa vjetësh, në tregun shqiptar të sigurimeve të jetës operojnë 4 kompani sigurimi. Edhe për vitin 2021 tregu u udhëhoq nga SIGAL Life UNIQA me 52.74% e cila ka paguar 41.52% të dëmeve të ndodhura në treg.



### Tregu i pensioneve vullnetare


Gjatë vitit 2021, në tregun e pensioneve operuan 4 fonde pensionesh vullnetare. Fondi i Pensionit Vullnetar SIGAL udhëhoqi tregun për vlerën e aseteve neto (44.58%).



## KOSOVË


### Tregu i sigurimeve jo-jetë

Në tregun kosovar operojnë 12 kompani sigurimi ndër të cilat SIGAL UNIQA Kosova renditet e para me rreth 12.50% të tregut për volumin e primeve si dhe ka paguar 11.08 % të dëmeve totale të tregut.



### Tregu i sigurimeve të jetës


Në tregun kosovar të sigurimeve të jetës operojnë 2 kompani ndër të cilat SIGAL Life UNIQA Kosova renditet e dyta me 29.61% të tregut për volumin e primeve dhe ka paguar 36.64 % të dëmeve.



## MAQEDONI E VERIUT


### Tregu i sigurimeve jo-jetë

Në tregun maqedonas të sigurimeve të jo-jetës operojnë 11 kompani. UNIQA a.d. u rendit në vendin e treta për nga volumi i primeve të shkruara (10.63%).



### Tregu i sigurimeve të jetës


UNIQA Life renditet e katërta në tregun maqedonas të sigurimeve të jetës (12.36%) në të cilin operojnë 5 kompani.






# TË DHËNA FINANCIARE

Grupi SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA  
Prime të shkruara për katër vitet e fundit (në euro)



Kompania	2018 (në Euro)	2019 (në Euro)	2020 (në Euro)	2021 (në Euro)
SIGAL UNIQA AL Jo-Jetë dhe Risigurime	32,247,000	34,899,661	31,429,000	37,453,000
SIGAL Life UNIQA AL	5,314,000	5,884,561	5,050,000	6,163,000
SH.A.F.P SIGAL Life UNIQA	2,088,000	2,124,432	2,357,000	4,661,000
SIGAL UNIQA KS Jo-Jetë	10,509,000	12,034,619	12,204,000	14,070,000
SIGAL Life UNIQA KS	856,000	1,116,295	1,073,000	1,436,000
UNIQA MKV Jo-Jetë	13,054,000	13,384,976	13,450,000	16,642,000
UNIQA Life MKV	1,583,000	2,403,932	2,970,000	4,023,000
<b>GRUPI</b>	<b>65,652,000</b>	<b>71,848,476</b>	<b>68,533,000</b>	<b>84,446,000</b>

Prime të shkruara sipas produkteve për vitin 2021



Lloji i Produktit	AL (në Euro)	KS (në Euro)	MKV (në Euro)	Grupi (në Euro)
Pasuri	9,773,734	2,161,671	3,676,989	15,612,394
Motorike	22,524,681	8,865,494	11,390,281	42,780,456
Jetë, Shëndet dhe Aksidente	10,443,768	4,382,612	5,357,638	20,184,018
Marina & Aviacioni	650,471	95,716	239,684	985,870
Risigurime*	222,660			222,660
Pensione Vullnetare*	4,660,996			4,660,996
<b>TOTALI</b>	<b>48,276,309</b>	<b>15,505,493</b>	<b>20,664,592</b>	<b>84,446,394</b>

\* Produktet e Pensioneve vullnetare dhe Risigurimet ofrohen vetëm në Shqipëri përkatësisht nga kompanitë SIGAL UNIQA Group AUSTRIA Risigurime dhe SH.A.F.P SIGAL Life UNIQA.

# RAPORTI I AUDITUESVE TE PAVARUR

SIGAL UNIQA Group AUSTRIA sh.a.

Pasqyrat Financiare të Konsoliduara sipas  
Standarteve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar  
per vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021

# Raporti i Audituesit të Pavarur

Për aksionarët e Sigal Uniqa Group Austria sh.a,

## Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të konsoliduara të Sigal Uniqa Group Austria sh.a (“Grupi”), të cilat përfshijnë pasqyrën e konsoliduar të pozicionit financiar më datë 31 dhjetor 2021, pasqyrën e konsoliduar të fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse, pasqyrën e konsoliduar të ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e konsoliduar të flukseve të parasë për vitin që mbyllet më këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat e konsoliduara financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë pasqyrat financiare të konsoliduara bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Grupit më datën 31 dhjetor 2021, dhe performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

## Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen *Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare të Konsoliduara*. Ne jemi të pavarur nga Grupi në përputhje me Kodin e Etikës të Kontabilistëve Profesioniste të njohur nga Bordi Ndërkombëtar i Etikave Standarde për Kontabilistët (IESBA), kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, si dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me kodin IESBA. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

## Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare të Konsoliduara

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare të konsoliduara në përputhje me SNRF-të, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare të konsoliduara që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Grupit për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Grupit.

## Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare të Konsoliduara

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare të konsoliduara në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por

nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare të konsoliduara.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë procesit të auditimit. Ne gjithashtu:

- identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare të konsoliduara, për shkak të gabimeve ose mashtrimeve, projektojmë dhe zbatojmë procedurë auditimi të cilat u përgjigjen këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidenca auditimi të plota dhe të mjaftueshme për të krijuar bazat e opinionit tonë. Rreziku i moszbulimit të një gabimi material që vjen si rezultat i një mashtrimi, është më i lartë se ai që vjen nga një gabim, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, mosveprime të qëllimshme, keqinterpretime, ose shkelje të kontrolleve të brendshme.
- marrim një kuptueshmëri të kontrollit të brendshëm në lidhje me auditimin, për të planifikuar procedurë të përshtatshme në varësi të rrethanave, dhe jo për të shprehur një opinionin mbi efektshmërinë e kontrolleve të brendshme të entitetit.
- vlerësojmë konformitetin e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël dhe informacioneve shpjeguese të bëra nga drejtimi.
- konkluojmë mbi përdorimin e duhur të parimit kontabël të vijimësisë nga drejtimi si dhe, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, konkluojmë nëse ekziston një pasiguri materiale e lidhur me ngjarje ose kushte të cilat mund të sjellin dyshime në aftësinë e entitetit për të vazhduar në vijimësi. Nëse konkluojmë që ekziston një pasiguri materiale, ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit për informacionet shpjeguese përkatëse në pasqyrat financiare ose, nëse keto informacione shpjeguese janë të pamjaftueshme, të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona janë të bazuara në evidencat e auditimit të marra deri në ditën e raportit tonë të audituesit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet e ardhshme mund të jenë shkak që entiteti të ndalojë së vazhduari në vijimësi.
- vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë dhënien e informacioneve shpjeguese, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet bazë në mënyrë të atillë që të arrijnë një prezantim të drejtë.
- Marrim evidencë të mjaftueshme të auditimit të duhur në lidhje me informacionin financiar të njëjësive ekonomike ose aktiviteteve të biznesit brenda Grupit për të shprehur një opinion mbi pasqyrat financiare të konsoliduara. Ne jemi përgjegjës për kryerjen e auditimit të Grupit. Ne mbetemi përgjegjës vetëm për opinionin tonë të auditimit.

Ne komunikojmë me ata të cilët janë të ngarkuar me qeverisjen, midis çështjesh të tjera, për qëllimin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet e rëndësishme gjatë auditimit, përfshirë çdo mangësi të theksuar në kontrollin e brendshëm të cilat ne i identifikojmë gjatë procesit të auditimit.

Grant Thornton sh.p.k.

Tiranë, Shqipëri  
31 maj 2022



**SIGAL UNIQA Group AUSTRIA Sh.a.**  
**Pasqyra e konsoliduar e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2021**  
*(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë Lek)*

	Shënime	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
<b>AKTIVET</b>			
Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre	9	392,266	325,060
Depozita me afat	10	9,415,497	9,552,649
Investime në letra me vlerë	11	2,397,820	1,733,865
Llogari të arkëtueshme nga sigurimi dhe të arkëtueshme të tjera	12	1,464,526	1,321,318
Aktive të risigurimit	13	1,423,107	1,720,138
Shpenzimet e shtyra të marrjes në sigurim	14	805,196	751,544
Inventari		10,311	4,689
Tatim fitimi i arkëtueshëm		47,828	110
Aktive afatgjata materiale	15	1,761,502	1,673,091
Aktive të tjera	16	744,040	511,258
<b>TOTALI AKTIVEVE</b>		<b>18,462,093</b>	<b>17,593,722</b>
<b>DETYRIMET</b>			
Detyrimet për humbje dhe shpenzimet për rregullimin e humbjes	17	5,321,626	5,255,065
Rezervat për primin e pafitur	18	4,723,072	4,324,851
Rezerva të tjera	17	1,886,760	1,700,468
Detyrime të tatimit mbi fitimin		14,398	91,855
Detyrime nga sigurimet dhe risigurimet	19	590,185	507,442
Detyrime të tjera	20	716,899	668,849
<b>TOTAL I DETYRIMEVE</b>		<b>13,252,940</b>	<b>12,548,530</b>
<b>KAPITALI</b>			
Kapitali themeltar	21	2,232,909	2,232,909
Rezerva të tjera të kapitalit	21	52,133	52,133
Rezerva të rezikut të sigurimit	22	719,856	693,621
Rezerva të konvertimit		(204,611)	(159,597)
Rezerva rivlerësimi		147,098	136,061
Fitime të mbartura		2,216,418	2,050,961
<b>Totali i kapitalit që i atribuohet pronarëve të shoqërisë mëmë</b>		<b>5,163,803</b>	<b>5,006,088</b>
<b>Interesi jo-kontrollues</b>		<b>45,350</b>	<b>39,104</b>
<b>TOTALI KAPITALIT</b>		<b>5,209,153</b>	<b>5,045,192</b>
<b>TOTALI KAPITALIT DHE DETYRIMEVE</b>		<b>18,462,093</b>	<b>17,593,722</b>

Këto pasqyra financiare të konsoliduara janë aprovuar nga drejtuesit e grupit më 16 maj 2022 dhe janë firmosur nga:

  
 Avni Ponari  
 Drejtor i Përgjithshëm



  
 Klement Mersini  
 Drejtor Finance

**SIGAL UNIQA Group AUSTRIA Sh.a.**  
**Pasqyra e konsoliduar e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse**  
*(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë Lek)*

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
Prime të shkruara bruto	23	9,763,715	8,183,234
Prime të ceduara në risigurim	24	(1,080,901)	(1,020,238)
<b>Prime bruto të fituara</b>		<b>8,682,814</b>	<b>7,162,996</b>
Ndryshimi në rezervën për prime të papërfituara	18	(434,304)	(54,361)
Ndryshimi në risigurim në rezervat e primeve të pafituara	13	(113,386)	(41,984)
<b>Të ardhura neto nga primet</b>		<b>8,135,124</b>	<b>7,066,651</b>
Të ardhura nga investimet		157,090	146,358
Të ardhura të tjera	25	321,714	248,258
		<b>8,613,928</b>	<b>7,461,267</b>
Ndryshimi në rezerva të tjera	18	(205,119)	(209,825)
Ndryshimi në pjesëmarrjen e risigurimit në rezervën e dëmeve	17	144,413	(221,920)
Dëme dhe shpenzime nga rregullimi i humbjeve	17	(3,761,523)	(2,440,646)
<b>Dëme të sigurimit neto</b>		<b>(3,822,229)</b>	<b>(2,872,391)</b>
Kostot e marrjes në sigurim	26	(1,901,931)	(1,604,291)
Shpenzime administrative dhe marketingu	27	(1,835,485)	(1,696,561)
Shpenzime të tjera sigurimi	28	(450,712)	(448,715)
Fitim nga kurset e këmbimit		(73,585)	22,358
<b>Fitimi para tatimit</b>		<b>529,986</b>	<b>861,667</b>
Tatimi mbi fitimin	29	(118,058)	(163,381)
<b>Fitimi i vitit</b>		<b>411,928</b>	<b>698,286</b>
<b>Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse</b>			
<b>Zërat që janë ose mund të riklasifikohen më pas në fitim ose humbje</b>			
Të ardhura nga rivlerësimi		35,678	(12,626)
Operacionet e huaja - diferencat në konvertimet në valutë të huaj		(50,046)	35,957
<b>Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse të vitit</b>		<b>397,560</b>	<b>721,617</b>
<b>Fitimi i atribueshëm për:</b>			
Pronarët e shoqërisë mëmë		405,550	688,951
Interesi jo-kontrollues	8	6,379	9,335
<b>Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse të atribueshme për:</b>		<b>391,314</b>	<b>712,282</b>
Pronarët e shoqërisë mëmë		6,246	9,335
Interesi jo-kontrollues			

**SIGAL UNIQA Group AUSTRIA Sh.a.**
**Pasqyra e konsoliduar e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021**
*(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë Lek)*

	Kapitali themeltar	Rezerva të tjera të kapitalit	Rezerva të rrezikut të sigurimit	Rezerva të konvertimit	Rezerva rivlerësimi	Fitime të mbartura	Të atribueshme për pronarët e shoqërisë mëmë	Interesi jo- kontrollues	Totali
<b>Më 1 janar 2020</b>	<b>2,232,909</b>	<b>52,133</b>	<b>589,996</b>	<b>(195,555)</b>	<b>148,688</b>	<b>1,465,635</b>	<b>4,293,806</b>	<b>29,769</b>	<b>4,323,575</b>
Fitimi i vitit	-	-	-	-	-	688,951	688,951	9,335	698,286
Rivlerësimi i Aktiveve Financiare	-	-	-	-	(13,157)	-	(13,157)	-	(13,157)
Rivlerësimi i Aktiveve Afatgjata	-	-	-	-	530	-	530	-	530
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse, neto nga taksat	-	-	-	35,958	-	-	35,958	-	35,958
<b>Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse të vitit</b>	-	-	-	<b>35,958</b>	<b>(12,627)</b>	<b>688,951</b>	<b>712,282</b>	<b>9,335</b>	<b>721,617</b>
Përvetësimi i fitimeve të mbartura	-	-	103,625	-	-	(103,625)	-	-	-
Dividendi i paguar	-	-	-	-	-	-	-	-	-
<b>Totali i kontributeve dhe shpërndarja tek pronarët</b>	-	-	103,625	-	-	(103,625)	-	-	-
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2020</b>	<b>2,232,909</b>	<b>52,133</b>	<b>693,621</b>	<b>(159,597)</b>	<b>136,061</b>	<b>2,050,961</b>	<b>5,006,088</b>	<b>39,104</b>	<b>5,045,192</b>
Fitimi i vitit	-	-	-	-	-	405,550	405,550	6,379	411,929
Rivlerësimi i Aktiveve Financiare	-	-	-	-	17,573	-	17,573	-	17,573
Rivlerësimi i Aktiveve Afatgjata	-	-	-	-	18,105	-	18,105	-	18,105
Shitja e Aktiveve Afatgjata	-	-	-	-	(19,741)	19,741	-	-	-
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse, neto nga taksat	-	-	-	(45,014)	(4,900)	-	(49,914)	(133)	(50,047)
<b>Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse të vitit</b>	-	-	-	<b>(45,014)</b>	<b>11,037</b>	<b>425,291</b>	<b>391,314</b>	<b>6,246</b>	<b>397,560</b>
Përvetësimi i fitimeve të mbartura	-	-	26,235	-	-	(26,235)	-	-	-
Dividendi i paguar	-	-	-	-	-	(233,599)	(233,599)	-	(233,599)
<b>Totali i kontributeve dhe shpërndarja tek pronarët</b>	-	-	26,235	-	-	(259,834)	(233,599)	-	(233,599)
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2021</b>	<b>2,232,909</b>	<b>52,133</b>	<b>719,856</b>	<b>(204,611)</b>	<b>147,098</b>	<b>2,216,418</b>	<b>5,163,803</b>	<b>45,350</b>	<b>5,209,153</b>



**SIGAL UNIQA Group AUSTRIA Sh.a.**  
**Pasqyra e konsoliduar e flukseve monetare**  
*(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë Lek)*

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021	Për vitin e mbyllur në 31 dhjetor 2020
<b>Flukset monetare nga aktivitetet operative</b>			
<b>Fitimi para tatimit</b>		<b>529,987</b>	<b>861,667</b>
<i>Rregullime për:</i>			
Zhvlerësimin	15	180,564	236,237
Shpenzimi për zhvlerësimin	12	50,831	(26,210)
Humbje nga shitja e aktiveve afat-gjata materiale		6,628	7,431
Të ardhura nga interesi		(157,090)	(146,358)
Efekti i konvertimit		(45,147)	35,955
<b>Flukset monetare të gjeneruara nga operacionet para ndryshimeve në aktivet dhe detyrimet operative</b>		<b>565,773</b>	<b>968,722</b>
<i>Ndryshime në aktive dhe detyrime operative:</i>			
Ndryshimi në llogari të arkëtueshme nga sigurimi		(194,039)	195,378
Ndryshimi në kostot e shtyra të marrjes në sigurim		(53,652)	8,171
Ndryshime në llogaritë e arkëtueshme nga risigurimi		297,031	957,283
Ndryshimi në aktivet e tjera		(238,404)	(204,652)
Ndryshimi në detyrime nga aktiviteti risiguroes		82,743	(178,803)
Ndryshimi në rezervat për kontratat e sigurimit		651,074	(467,529)
Ndryshimi në detyrimet e tjera		48,050	(90,198)
Interesa të marra		157,090	146,358
Tatim fitimi i paguar		(243,233)	(29,952)
<b>Flukset monetare të gjeneruara nga aktivitetet operative</b>		<b>1,072,433</b>	<b>1,304,778</b>
<b>Flukset monetare nga aktivitet investuese.</b>			
Blerje e aktiveve afatgjata materiale	15	(310,807)	(248,979)
Shitje a aktiveve afatgjata	15	54,945	82,933
Shuma të marra/vendosje në depozitat me afat		137,152	(1,148,789)
Rënie/(Rritje) e investimeve në letrave me vlerë		(652,918)	8,744
<b>Flukset neto monetare të përdorura në aktivitetin investues</b>		<b>(771,628)</b>	<b>(1,306,091)</b>
<b>Flukset monetare nga aktivitetet financuese</b>			
Dividendët e paguar	21	(233,599)	-
<b>Flukset neto monetare të përdorura në aktivitetet financuese</b>		<b>(233,599)</b>	<b>-</b>
<b>(Rënie) neto në mjetet monetare dhe ekuivalentë të tyre</b>			
<b>Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre në fillim të vitit</b>		<b>325,060</b>	<b>326,373</b>
<b>Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre në fund të vitit</b>	9	<b>392,266</b>	<b>325,060</b>

## Raport kontrolli auditi i brendshëm për vitin 2021 SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA

Në Shoqërinë Sigal Uniqa Group Austria, Ne si Departament i Auditit, përgjatë gjithë vitit 2021 kemi bërë auditime të vazhdueshme në të gjithë departamentet e kompanisë duke u bazuar në ligjin Nr. 52/2014 "Për Veprimtarinë e Sigurimit dhe Risigurimit". Këto auditime janë bërë konform planit të punës që ne kemi hartuar në fillim të vitit dhe të miratuar nga ana e Uniqa Group Audit dhe Këshillit Administrativ të Kompanisë. Gjatë vitit ka edhe auditime të rekomanduara nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të Kompanisë për probleme të punës dhe kontrollin e përmirësimin e saj duke e bërë punën e Departamentit të Auditit fleksibël duke u bazuar tek risku. Shoqëria gjatë vitit 2021 ka një rritje të primeve në krahasim me vitin 2020 dhe gjithashtu ka mundur të ruajë rolin e liderit në tregun e sigurimeve, të përballojë të gjitha shpenzimet për klientet dhe shoqëritë e siguruar dhe ta mbyllë vitin 2021 me fitim në rezultatin financiar të saj. Më hollësisht për punën e bërë do të paraqesim si më poshtë:

**Departamenti Pasurisë.** Në Departamentin e Pasurisë është punuar mirë gjatë vitit 2021. Janë plotësuar drejtë e saktë të gjithë rregjistrat e marrjes në sigurim, duke dërguar në kohë të gjitha evidencat e kërkuara si nga Uniqa Group Austria, Autoriteti Mbikëqyrës Financiar dhe Statistika në kompani. Rinovimet e policave shumëvjeçare bëhen sipas afateve të rinovimit, si edhe bëhet plotësimi i policave të reja. Është punuar në drejtim të plotësimit të planeve të sigurimit vendosur në fillim të vitit duke u përballur me konkurrencën e fortë në tregun e sigurimeve midis kompanive të tjera në fushën e sigurimit. Primet e sigurimit janë realizuar më shumë se viti 2020 në shumën 237,482,517 Lekë. Për secilin produkt sigurimi, të ardhurat për Departamentin e Pasurisë janë realizuar si më poshtë:

Emërtimi	Viti 2021 (Në Lekë)
Të Ardhura nga Zjarri	692,894,444
Të Ardhura nga CAR	44,666,030
Të Ardhura nga G. Oferte + Kontrate	109,232,205
Të Ardhura nga Bankat	80,426,307
Të Ardhura nga Përgjegjësi	269,645,450
Të Ardhura nga Bujqësi & Blegtori	159,091
<b>Shuma Të Ardhura Pasuria</b>	<b>1,197,023,527</b>

Gjatë vitit 2021 janë paguar 350,057,441 Lekë për dëmet e Departamentit të Pasurisë. Krahasuar me vitin 2020 janë paguar më pak 411,339,113 Lekë, por kjo është normale duke konsideruar se në vitin 2020 janë paguar edhe dëmet e tërmetit të nëntorit të vitit 2019. Sigal Uniqa Group është gjendur pranë klientëve të saj duke bërë të mundur pagesën e të gjithë dëmeve të shkaktuara. Dëmet e paguara për Departamentin e Pasurisë janë si më poshtë:

Emërtimi	Viti 2021
Dëme Paguara Zjarr+Inxhinierike+ Bankë+Bujqësi & Blegtori	306,519,992
Dëme Paguara Sigurime Garanci	41,111,048
Dëme Paguara Sigurime Përgjegjësi	2,426,400
<b>Shuma</b>	<b>350,057,441</b>

Sipas përqindjeve të hartuara dhe miratuara nga Drejtori i Përgjithshëm, është bërë pagesa për komisionet e agjenteve, brokerave në sigurime, bankave me të cilat kompania ka marrëdhënie, etj. Këto komisione zënë mesatarisht rreth 16% të primeve të sigurimit dhe janë si më poshtë:

Emërtimi	Viti 2021
Komisione Zjarr+Inxhinierike+ Bankë+Bujqësi & Blegtori	103,927,687.85
Komisione Sigurime Garanci	23,031,402.94
Komisione Sigurime Përgjegjësi	62,688,518.45
<b>Shuma</b>	<b>189,647,609.24</b>

Për të gjitha produktet e sigurimit në Departamentin e Pasurisë, kompania është e kujdeseshme dhe ka punuar për risigurimin e këtyre kontratave të bëra në mënyrë që në raste rreziqesh të mëdha të bëjë të mundur ecurinë normale të aktivitetit të saj. Kjo gjë u pa fare mirë në rastin e tërmetit të ndodhur në nëntor të vitit 2019, ku nga dëmet e mëdha që u shkaktuan, kompania kompensoi nga risigurimet e bëra, rreth 90% të dëmeve të ndodhura në sigurimet nga zjarri-tërmetet. Pagesat për risigurimet që ka bërë kompania Sigal Uniqa Group Austria gjatë vitit 2021 për Departamentin e Pasurisë janë si më poshtë:

Emërtimi	Viti 2021
Risigurime Zjarr+Inxhinierike+ Bankë+Bujqësi & Blegtori	430,522,061
Risigurime Garanci Kontrate + Ofertë	28,061,253
Risigurime Sig.Përgjegjësie	74,189,804
<b>Shuma Risigurime</b>	<b>532,773,118</b>

Duke marrë për bazë të gjithë këto elemente që ne pasqyrojmë më sipër, për të parë efektivitetin ekonomik-financiar në fund të vitit 2021, nga ana jonë është hartuar një pasqyrë përmbljedhëse me të gjithë këto elemente si më poshtë:

Analizë Departamenti i Pasurisë						
Emërtimi	Primet	Dëmet Paguar	Risigurime Paguar	Komisione Agjenti	Shuma Shpenzime	Diferenca
Prime Zjarr+Inxhinierike+ Bankë+ Bujqësi & Blegtori	818,145,873	306,519,992	430,522,061	103,927,687.85	840,969,741	-22,823,868
Prime Sigurime Garanci	109,232,205	41,111,048	28,061,253	23,031,402.94	92,203,704	17,028,500
Prime Sigurime Përgjegjësi	269,645,450	2,426,400	74,189,804	62,688,518.45	139,304,723	130,340,727
<b>Shuma Pasuria</b>	<b>1,197,023,527</b>	<b>350,057,441</b>	<b>532,773,118</b>	<b>189,647,609</b>	<b>1,072,478,168</b>	<b>124,545,360</b>

Në tabelë shihet që shpenzimet e bëra për dëme, risigurime dhe komisione agjentësh janë më të vogla se të ardhurat e realizuara nga primet e sigurimit dhe departamenti ka efektivitet. Gjithsesi duhet të konsiderohen edhe shpenzimet administrative të kryera nga kompania.

#### Departamenti Motorrik.

Edhe në këtë departament është punuar mirë. Organizimi dhe funksionimi i një rrjeti të degëve dhe agjensive në të gjithë territorin, ka bërë që puna në realizimin e produkteve të sigurimit TPL, Kasko, Karton Jeshil dhe Kufitare, kompania të ruajë rolin e liderit në tregun e sigurimeve. Edhe regjistrat dhe pasqyrat e domosdoshme për raportimet që bëhen plotësohen në afat dhe sipas formateve të miratuara. Primet e realizuara për vitin 2021 janë më të larta se në vitin 2020 në vlerën 305,740,686 Lekë, dhe kjo tregon punën e mirë të kryer nga Departamenti Motorrik gjatë vitit 2021. Realizimi i produkteve të sigurimit sipas llojit të tij për Departamentin Motorrik për vitin 2021 është si më poshtë:

Emërtimi	Viti 2021
Të Ardhura nga TPL	2,092,216,280
Të Ardhura nga Kasko	242,169,172
Të Ardhura nga Karton Jeshil	323,958,288
Të Ardhura nga Kufitare	102,449,486
<b>Shuma Të Ardhura Motorrike</b>	<b>2,760,793,227</b>

Dëmet e ndodhura të paguara normalisht shkojnë në raport me realizimin e volumit të primeve të sigurimit, kur situatat gjatë vitit nuk japin fenomene të paparashikuara. Dëmet gjatë vitit 2021 janë në vlerën 1,075,628,595 Lekë ose 420,611,572 Lekë më shumë se viti 2020. Kjo rritje ka ardhur si pasojë e kufizimeve në lëvizje që kanë qenë në vitin 2020, ndërsa në vitin 2021 lëvizja ka qenë pa kufizime. Për secilin lloj siguri dëmet e paguara për vitin 2021 janë si më poshtë:



Emërtimi	Viti 2021
Dëme të Paguara Sigurime TPL	699,689,133
Dëme të Paguara Sigurime Kasko	193,730,424
Dëme të Paguara Sigurime Kartoj Jeshil	172,337,838
Dëme të Paguara Sigurime Kufitare	9,871,200
<b>Shuma</b>	<b>1,075,628,595</b>

Rrjeti i agjentëve të kompanisë është paguar me komisionet për policat e sigurimit të shitura konformë përqindjeve të miratuara për këtë qëllim. Në total shuma e paguar për komisione agjentësh në Departamentin Motorrik është 538,913,834 Lekë ose e barabartë mesatarisht me rreth 19,5% të primeve të sigurimit.

Komisionet e paguara po i paraqesim në pasqyrën më poshtë:

Emertimi	Viti 2021
Komisione Agjenti Sigurime TPL	401,511,149
Komisione Agjenti Sigurime Kasko	48,061,281
Komisione Agjenti Sigurime Karton Jeshil	60,879,344
Komisione Agjenti Sigurime Kufitar	28,462,059
<b>Total Komisone</b>	<b>538,913,834</b>

Risigurimet, siç vepohet në çdo departament, janë bërë korrekt për të patur një ecuri normale të punës dhe ulur rreziqet që mund të ndodhin, kjo në Departamentin Motorrik kryesisht në produktin e sigurimit Karton Jeshil, i cili ka edhe risqet më të larta të marrjes në sigurim. Pagesat e bëra për risigurime për vitin 2021 janë sipas pasqyrës më poshtë:

Emërtimi	Viti 2021
Risigurime Sigurim TPL	28,972,838
Risigurime Sigurim Kasko	1,169,494
Risigurime Sigurim Karton Jeshil	24,295,700
Risigurime Sigurim Kufitar	0
<b>Shuma Risigurime</b>	<b>54,438,032</b>

Si për Departamentin e Pasurisë, edhe për Departamentin Motorrik, nga ana jonë duke përpiluar një pasqyrë me treguesit më sipër, shohim efektivitetin financiar të tij në tregues të përgjithshëm për vitin 2021. Nga pasqyra shihet që në total departamenti ka efektivitet pozitiv, porë nga të ardhurat e realizuara nga primet e sigurimit dhe shpenzimet e bëra. Kjo në shumën 1,091,812,766 Lekë. Por duhet të konsiderojmë që edhe për Departamentin Motorrik ka edhe shpenzime administrative të kryera nga kompania. Një analizë në të gjitha produktet e tij nxjerr që produkti i sigurimit Kasko është me efektivitet negativ.

Vëmendja në këtë produkt sigurimi kryesisht në rritjen e të ardhurave nga primet, por edhe në një ulje të shpenzimeve do të bënte që departamenti të kishte rezultate ekonomike e financiare më të larta për vetë departamentin, por dhe kompaninë në tërësi. Më poshtë është kjo pasqyrë e përgatitur nga ana e jonë.

Analiza Motorrike						
Emërtimi	Primet	Dëmet Paguar	Risigurime Paguar	Komisione Agjenti	Shuma Shpenzime	Diferenca
Sigurime TPL	2,092,216,280	699,689,133	28,972,838	401,511,149	1,130,173,120	962,043,160
Sigurime Kasko	242,169,172	193,730,424	1,169,494	48,061,281	242,961,200	-792,027
Sigurime Karton Jeshil	323,958,288	172,337,838	24,295,700	60,879,344	257,512,882	66,445,406
Sigurime Kufitare	102,449,486	9,871,200	0	28,462,059	38,333,259	64,116,227
<b>Shuma Motorrike</b>	<b>2,760,793,227</b>	<b>1,075,628,595</b>	<b>54,438,032</b>	<b>538,913,834</b>	<b>1,668,980,461</b>	<b>1,091,812,766</b>

**Departamenti Shëndetit:** Departamenti i Shëndetit operon kryesisht me tre produkte në fushën e sigurimit, siç janë Shëndeti në Udhëtim, Shëndeti Privat dhe Aksidentet Personale. Këto janë emërtimet kryesore pasi brenda secilit produkt për klientët ka alternativa të ndryshme. Për vitin 2021 kemi një rritje të primeve prej 98,186,560 Lekë në krahasim me realizimin e vitit 2020. Primet e sigurimit të realizuara për vitin 2021 janë:

Emërtimi	Viti 2021
Të Ardhura Shëndet në Udhëtim	136,350,600
Të Ardhura Shëndeti Privat	333,041,207
Të Ardhura Aksidente	55,161,337
<b>Shuma Të Ardhura Shëndeti</b>	<b>524,553,144</b>

Gjatë gjithë vitit 2021 dëmet e ndodhura në Departamentin e Shëndetit nga kompania Sigal Uniqa Group Austria janë paguar rregullisht duke mos sjellë asnjë shqetësim te klientët e saj. Pagesat e bëra janë 58,974,502 Lekë më shumë se viti 2020, e cila është normale duke konsideruar rritjen e primeve. Për çdo produkt sigurimi dëmet e paguara janë sipas pasqyrës më poshtë:

Emërtimi	Viti 2021
Dëme Paguara Shëndet në Udhëtim & Shëndet Privat	274,655,710
Dëme Paguara Aksidente	14,611,687
<b>Shuma</b>	<b>289,267,398</b>

Pagesat e komisioneve për agjentët e kompanisë, brokerat etj., janë në shumën 91,415,145 Lekë ose 17,5% e primeve të sigurimit gjë që është brenda kufinjve të miratuar për këto pagesa.

Edhe komisionet për agjentët po i paraqesim në pasqyrën më poshtë:

Emërtimi	Viti 2021
Komisione Agjenti Shëndet në Udhëtim	35,222,558
Komisione Agjenti Shëndet Privat	37,819,724
Komisione Agjenti Aksidente	18,372,863
<b>Total Komisone</b>	<b>91,415,145</b>

Risigurimet në zërat e produkteve të shëndetit janë kryesisht në raste të veçantë për produktin Shëndet Privat dhe Aksidente kur klientë të veçantë sigurohen në shuma të mëdha përfitimi, për rastet e tjera nuk është aplikuar, pasi edhe rreziqet mundet të përballohen nga vetë kompania.

Pagesat për risigurime janë si më poshtë:

Emërtimi	Viti 2021
Risigurime Shëndet në Udhëtim & Privat	2,680,464
Risigurime Aksidente	1,458,240
<b>Shuma Risigurime</b>	<b>4,138,704</b>

Një analizë me të gjitha të dhënat e përmendura më sipër për Departamentin e Shëndetit, siç edhe kemi përshkruar na tregon se të ardhurat e realizuara nga primet e sigurimit janë më të mëdha se shpenzimet e bëra, por duhet të konsiderojmë edhe shpenzimet administrative. Në analizën e produkteve analitike këtë situatë e sjell Sigurimi i Shëndetit Privat pasi ky produkt ka edhe peshën më të madhe. Për këtë produkt sigurimi duhen marrë masa në rritjen e të ardhurave nga primet e sigurimit, ose parë mundësia e uljes së shpenzimeve, në mënyrë që produkti të dalë me efektivitet më të lartë dhe po kështu edhe departamenti. Të dhënat e pasqyrës janë si më poshtë:

Analiza Shëndeti						
Emërtimi	Primet	Dëmet Paguar	Risigurime Paguar	Komisone Agjenti	Shuma Shpenzime	Diferenca
Sigurime Shëndet në Udhëtim & Privat	469,391,807	274,655,710	2,680,464	73,042,282	350,378,457	119,013,350
Sigurime Aksidente	55,161,337	14,611,687	1,458,240	18,372,863	34,442,790	20,718,547
<b>Shuma Shëndeti</b>	<b>524,553,144</b>	<b>289,267,398</b>	<b>4,138,704</b>	<b>91,415,145</b>	<b>384,821,247</b>	<b>139,731,897</b>

**Departamenti Marinës:** Ka rritje të ndjeshme të primeve të sigurimit krahasuar me vitin e kaluar. Por kjo ka ardhur si pasojë, pasi për vitin 2020 nuk ka patur asnjë sigurim në zërin "Sigurim Avione", ndërsa për vitin 2021 ka prime në vlerën 32,625,025 Lekë. Për vitin 2021 të ardhurat nga Departamenti i Marinës janë si më poshtë:

Emërtimi	Viti 2021
Të Ardhura Sigurime Mall në Transport	39,642,554
Të Ardhura Sigurime Anije	7,398,595
Të Ardhura Sigurime Avione	32,625,025
<b>Shuma Të Ardhura Marina</b>	<b>79,666,174</b>

Dëmet e paguara gjatë vitit 2021 janë për sigurimet e mallit në transport dhe në shifra të vogla e jo problematike. Janë paguar dëme për vitin 2021 si më poshtë:

Emërtimi	Viti 2021
Dëme Sigurim Marine & Mall në Transport	2,275,080
<b>Shuma Marine &amp; Aviacion</b>	<b>2,275,080</b>

Komisinet e agjentëve për sigurimet e bëra në Departamentin e Marinës janë në shumën 18,438,109 Lekë, që janë 10,041,713 Lekë më shumë se viti 2020. Normalisht kjo rritje e madhe e komisioneve vjen si pasojë e rritjes së primeve. Komisionet janë rreth 23% e primeve të sigurimit.

Janë paguar komisione agjentesh për vitin 2021 si më poshtë:

Emërtimi	Viti 2021
Komisone Agjenti Sigurime Mall në Transport	8,313,611
Komisone Agjenti Sigurime Anije	1,162,919
Komisone Agjenti Sigurime Avione	8,961,579
<b>Total Komisione</b>	<b>18,438,109</b>

Risigurimet për Departamentin e Marinës bëhen rregullisht. Vërejmë se për vitin 2021 risigurimet janë në të njëjtat nivele me vitin 2020.

Janë paguar risigurime për Departamentin e Marinës si më poshtë:

Emërtimi	Viti 2021
<b>Shuma Risigurime Marina</b>	<b>45,789,954</b>

Në analizën e Departamentit të Marinës lidhur me të ardhurat e realizuara dhe shpenzimet e bëra duhet të theksojmë sa ky departament ka efektivitet në sigurimet që bën.

Pasqyra e përgatitur për Departamentin e Marinës është si më poshtë:



Analiza Marinë Aviacion						
Emërtimi	Primet	Dëmet Paguar	Risigurime Paguar	Komisione Agjenti	Shuma Shpenzime	Diferenca
<b>Shuma Marinë Aviacion</b>	<b>79,666,174</b>	<b>2,275,080</b>	<b>45,789,954</b>	<b>18,438,109</b>	<b>66,503,143</b>	<b>13,163,031</b>

Një analizë për të gjithë departamentet së bashku, ku jepet performanca e kompanisë, nga të dhënat që paraqitëm më sipër na jep një rezultat të tillë për kompaninë. Të ardhurat e realizuara nga primet e sigurimit për vitin 2021 janë në shumën 4,589,269,478 Lekë. Në krahasim me vitin 2020, kemi një rritje të konsiderueshme prej 698,874,017 Lekë si pasojë e punës së mirë të kryer nga departamentet e shitjeve, ndërsa shpenzimet për të gjithë zërat së bashku në shumën 4,204,168,881 Lekë, që në diferencë japin një efekt pozitiv në vlerën 385,100,597 Lekë. Si konkluzion përmendim që duhet të shihen rekomandimet e vendosura për çdo departament, në pasqyrë-analizat e përgatitura si dhe del në pah rëndësia e madhe që kanë risigurimet e duhura dhe korrekte, të cilat kompania i zbaton rregullisht.

**Departamenti Financës:** Në kontrollet në vazhdimësi gjatë vitit, bërë nga ana jonë, vërejmë se nga ana e Departamentit të Financës është zbatuar me korrektesë plani unik kontabël i miratuar, dhe po kështu edhe të gjitha standartet ndërkombëtare që aplikohen për financën (SNRF-të). Gjatë vitit 2021 në Departamentin e Financës ka vazhduar si edhe në vitin 2020 mbajtja e kontabilitetit në programin financiar SAP, që me gjithë vështirësitë e fillimit si program i ri, në vazhdim po ecën normalisht. Të gjitha llogaritë e prekura me veprime financiare gjatë vitit kanë pozicione të rregullta "debitore" dhe "kreditore" dhe janë të rakorduara me llogaritë analitike korespondente. Ato paraqesin gjendjen reale të kompanisë me datë 31 dhjetor 2021 në të gjithë treguesit e saj. Bilanci financiar është mbyllur saktë. Paraqitja sintetike e tij me aktivin e llogarive dhe pasivin e tyre është si më poshtë:

Bilanci Sigal 2021	
Aktivi	Viti 2021 (Lekë)
Mjete Monetare në arkë dhe bankë	77,652,387
Depozita me afat në banka	4,511,556,433
Investime në pjesëmarrje	2,223,049,985
Llogari të arkëtueshme të sigurimit	529,131,689
Kosto marrjes në sigurim për tu shpërndarë	409,998,160
Tatim Fitimi për tu marrë	26,051,655
Rezerva tek risiguresit	893,948,777
Aktive tjera	498,230,262
Toka, Ndërtesa dhe të Tjera, Neto.	900,203,793
Automjete, Pajisje dhe Tjera, Neto	135,806,065
<b>Shuma Aktivi</b>	<b>10,205,629,206</b>

Pasivi	Viti 2021 (Lekë)
Provigjone për primin e pafituar	2,327,167,764
Provigjone për dëmet	2,878,821,873
Tatim Fitimi për tu paguar	-
Llogari të pagueshme	613,515,851
Provigjone për shpenzime	159,982,485
Kapitali i nënshkruar	2,232,909,184
Rezerva kapitali	260,495,949
Fitime të mbartura	1,358,791,559
Fitime të vitit	373,944,541
<b>Shuma Pasivi</b>	<b>10,205,629,206</b>

Kompania Sigal Uniqa Group Austria ka arritur të realizojë për këtë vit një fitim bruto prej 437,292,886 Lekë. Për të paraqitur realizimin e këtij fitimi, ne kemi përgatitur pasqyrën e të ardhurave e shpenzimeve analitike të kompanisë. Elementet analitike të të ardhurave e shpenzimeve financiare për kompaninë për vitin 2021 janë si më poshtë:

Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve	Për vitin që mbyllet më 31.12.2021
Prime të shkruara bruto	4,589,269,478
Prime të kalura në Risigurim	-637,139,809
Ndryshimi në rezervën e primit të Pafituar të sigurimit	-150,232,839
Ndryshimi në rezervën e primit të Pafituar të risigurimit	-86,796,515
Prime të sigurimit dhe risigurimit, Neto	3,715,100,315
Të ardhura të tjera	95,355,028
<b>Të ardhura Neto</b>	<b>3,810,455,343</b>
Dëme të paguara	-1,717,228,513
Dëme të paguara nga risiguresit	319,301,218
Ndryshimi i rezervës së dëmeve të sigurimit	35,885,955
Ndryshimi i rezervës së dëmeve të risigurimit	-174,887,784
Dëme të sigurimit, neto	-1,536,929,125
Shpenzime të marjes në sigurim	-778,362,580
Shpenzime marketingu dhe administrative	-977,375,174
Shpenzime të tjera operative	-132,687,868

Zhvlerësimi i Investimeve në Pjesëmarrje	
Taksa e primeve	
<b>Fitimi operativ</b>	<b>385,100,597</b>
Të ardhura nga interesat dhe pjesëmarrjet	123,902,292
Shpenzime nga Interesat për qeratë	-11,415,643
Të ardhura/Shpenzime nga kurset e këmbimit	-60,294,360
<b>Të ardhura financiare, neto</b>	<b>52,192,290</b>
<b>Fitimi para tatimit</b>	<b>437,292,886</b>
<b>Tatim fitimi</b>	<b>63,348,345</b>
<b>Fitimi neto i vitit</b>	<b>373,944,541</b>

Kapitali i nënshkruar me lëvizjet e tij për kompaninë është në nivele stabil. Ndryshimet e tij vijnë kryesisht nga fitimet e realizuara në vite apo edhe rastet kur është vendosur shpërndarje fitimi në formën e dividendit. Ndryshimet në kapital për vitin 2021 janë sipas pasqyrës më poshtë:

Pasqyra e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2021 (Lekë)					
	Kapitali i nënshkruar	Fitimet e mbartura	Rezerva te Tjera	Rezervat e Kovertimit	Totali
<b>Më 31 Dhjetor 2020</b>	<b>2,232,909,184</b>	<b>1,592,390,559</b>	<b>260,495,949</b>	<b>0</b>	<b>4,085,795,692</b>
Dividend i paguar	0	-233,599,000	0	0	0
Fitimi i vitit 2021	0	373,944,541	0	0	373,944,541
<b>Më 31 Dhjetor 2021</b>	<b>2,232,909,184</b>	<b>1,732,736,101</b>	<b>260,495,949</b>	<b>0</b>	<b>4,226,141,234</b>

Kompania ka një gjendje monetare të qëndrueshme, në rritje nga viti 2020. Mjetet e saj monetare janë në depozita bankare, të shpërndara thuajse në të gjitha bankat e nivelit të dytë, me të cilat kompania edhe bashkëpunon në fushën e sigurimeve. Për të paraqitur gjendjen e mjeteve monetare në llogaritë e saj bankare dhe në depozita në fund të vitit 2021 nga ana e jonë është përgatitur pasqyra më poshtë:

Mjete Monetare në Arkë dhe Bankë	Viti 2021
Mjete Monetare në Arkë	2,742,249
Mjete monetare Bankë Lekë	28,305,794
Mjete monetare Bankë Euro	34,945,627
Mjete monetare Bankë Usd	11,658,718
<b>Shuma (A)</b>	<b>77,652,388</b>
<b>Depozitat me afat në Banka</b>	<b>Viti 2021</b>

Depozita bankare në Lekë	704,000,000
Depozita bankare në Euro	3,431,068,181
Depozita bankare në Usd	366,817,220
<b>Shuma</b>	<b>4,501,885,401</b>
<b>Interesa të përlogaritur Viti</b>	<b>9,671,032</b>
<b>Totali (B)</b>	<b>4,511,556,433</b>
<b>Gjithësej Mjete Monetare</b>	4,589,208,821
<b>Kurset Fikse</b>	Viti 2021
<b>Euro</b>	120.76
<b>Usd</b>	106.54

Gjendjet në llogaritë bankare dhe depozita sipas bankave të nivelit të dytë me të cilat Kompania Sigal Uniq Group Austria punon, për vitin 2021 janë sipas pasqyrës më poshtë:

Viti 2021 (në mijë LEK)			
	Cash	Depozita	Total
BKT	14,559	1,786,814	1,801,373
ISP	13,030	47,425	60,455
RFZ	5,433	36,223	41,656
Credins	6,481	577,813	584,294
ABI	3,396	842,600	845,996
OTP	8,954	558,225	567,179
Procredit	4,469	182,126	186,595
T. Bank	2,541	401,527	404,068
UBA	3,437	-	3,437
Alpha bank	3,727	10,000	13,727
Union bank	6,298	59,133	65,431
FIB	2,585	-	2,585
<b>Total</b>	<b>74,910</b>	<b>4,501,886</b>	<b>4,576,796</b>

Kompania ka bërë investime gjatë viteve në krijimin e filialeve të saj në Sigal Kosovë dhe Sigal Maqedonia e Veriut, po kështu në Sigal Life Shqipëri, Kosovë dhe Maqedonia e Veriut. Këto shuma nuk kanë ndryshime nga viti 2020 dhe në fund të vitit 2021 paraqiten si më poshtë:

Investime në Pjesëmarrje	31.12.2021	31.12.2020
Emërtimi		
Investimi në SIGAL Non Life - Kosovë	554,409,000	554,409,000
Investimi në SIGAL Life - Kosovë	491,727,510	491,727,510



Investimi në Unqia Ad - Maqedoni	318,874,475	318,874,475
Investimi në Unqia Life Ad - Maqedoni	488,040,000	488,040,000
Investimi në Sigal Life - Albania	369,999,000	369,999,000
<b>Total</b>	<b>2,223,049,985</b>	<b>2,223,049,985</b>

Shtesat e paksimet e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara janë regjistruar drejtë e saktë. Edhe llogaritja e amortizimit vjetor të aktiveve është bërë brenda normave të miratuara për secilin lloj të aktivitetit të trupëzuar dhe patrupëzuar dhe gjendja në fund rakordon me listat analitike të tyre. Lëvizjet e aktiveve të qëndrueshme trupëzuara me gjendjet e tyre në fillim të vitit, lëvizjet gjatë vitit dhe gjendjet në fund të vitit bruto dhe neto, së bashku me amortizimin, janë si pasqyra më poshtë:

Lëvizjet	Toka	Ndërtesa	Automjete	Pajisje Zyre, Informatike dhe te tjera	Shpenzime për përmirësimin e objekteve me qira	Totali
